	këmbën lart: para dhe mbrapa në 90*, mbi shputën e këmbës, në pullupas, me plie-releve duke mbaruar në pullupals dhe nga pullupals duke mbaruar në demi-plie. - Gjysmë rrotullimi *en dehors* dhe *endedansme plie-releve*. - me këmbën e tendosur para dhe mbrapa në 45* dhe 90*. - *Pirouettes en dehors dhe en dedans* duke filluar me këmbën lart, anash dhe mbrapa në 45*. - *Pirouettes en dehors dhe en dedans me temps releve*. - *Flic me pirouettë en dehors dhe en dedans*, duke filluar me këmbën lart, në pozicionin e II në 45*. - Pirouettes tire bouchon en dehors en dedans duke filluar nga pozicioni V dhe nga poza 90*. - *Tour fouettë në 45* en dehors endedans*		
Mesi i sallës	- Battements fondus en tournant en dehors , en dedans me ¼ e rrethit. - *Battements frappe en tournant en dehors en dedans me 1/8, ¼, e rrotullimit me majën në tokë dhe në 30**. - Battements frappes doubles en tournant, en dehors en dedans në 1/8 dhe ¼ e rrethit me majën në tokë dhe në 30*. - Battements battus sur le cou de pied para dhe mbrapa, *en face* dhe *e pou lement.* - *Flic-flac en tournant en dehors en dedans* ku mbaron në pozicionin V dhe në IV. - *Rond de jambe en l'air en dehors en dedans, doubles në gjithë shputën e këmbës, në pullupals dhe mbaron në demi-plie, en tournant* në gjithë shputën e këmbës, *në 90** në të gjithë shputën e këmbës *(1-2 ronds)*. - Battements developpe: tombes en face dhe në pozën e fundit me majën në	- realizon grupin e ushtrimeve në mesin e sallës duke kuptuar shkallën e veshtirësisë; - zhvillon "*aplomb*" duke punuar gjithë ushtrimet në gjysmë shputën e këmbës; - realizon *Battement releve lents e battements developpe*s në gjysmë shputë; - realizon lëvizjet e reja në "*en tournant*" dhe *pirouettes* nga pozat e mëdha.	156 orë

	tokë dhe në 90*, ballottes, demi-ronds e ronds de jambe developpes *en dehors en dedans en face* dhe nga poza në pozë në pullupals, me demi-plie dhe me plie-releve. - *Tours lents en dehors en dedans* në pozat të mëdha, *në demi-plie*, nga poza në pozë (pa e lëvizur trupin*)*. - *Grand temps releveen face en dehors dhe en dedans*. - *Grands battements jetes në pullupals*. - *Grand por de bras preparacioni i* rrotullimeve të mëdha. - *Grand fouettë en face* e mbajtur *coupe-passe*, duke mbaruar *në attitude efface, arabesque I dhe II*. - *Battements divises en quarts (battements quadrupli)*. - *Temps lie par terre me pirouettes en dehors en dedans.* - Rrotullimet *en dehors en dedans* nga poza në pozë me *passé në 45*, 90* me plie-releve*. - *Pirouettes en dehors dhe en dedans nga pozicioni II, IV, V (2-3 rrotullime).* - *Pirouettes en dehors dhe en dedans e marre me temps releve (1-2 rrotullime).* - *Pirouettes en dehors dhe en dedans e marre me temps sauté* në pozicionin I dhe V, *me pas echappe* në pozicionin e II (1-2 rrotullime). - P*irouettës* en dehors me këmbën në sur le cou de pied dhe në attitude para në 45* e ndjekur me (2-4 rrotullime pa e mbyllur në të V). - *Pirouettes sur le cou de pied dhe pirouettes tire-bouchon, (passé lart) en dehors en dedans e mbajtur me grand plie në pozicionin I dhe V*. - *Pirouettes tire-bouchon en dehors en dedans* nga pozicioni V , IV (2 rrotullime). - Tours fouettës në 45* (4-8 rrotullime).		

	- *Tours en dehors en dedans* në të gjitha pozat e mëdha nga pozicioni IV dhe pozicioni II. - *Pirouettes en dehors en dedans* e mbajtur në *degage* në diagonal (4-8 rrotullime).		
Hedhjet	- *Entrechat-quatre* e spostuar. - *Royal e* spostuar. - .*Pas assemble en tournant* me ¼ e rrethit. - *Pas brise para dhe mbrapa*. - *Petit pas jete battu*. - *Pas jete ferme* në të gjitha drejtimet e pozat. - *Pas ballotte* (me majën në tokë) në 2 forma. - *Pas failli* para dhe mbrapa - *Sissonne fondue*. - *Grand sissonne ouvertë* në të gjitha drejtimet dhe pozat (duke u spostuar). - *Sissonne ouvertë pas developpe en tournant en dedehors en dedans*, hap këmbën anash në 45*. - *Grand sissonne tombee në të gjitha* drejtimet dhe pozat. - *Pas ballowë battu* në krah dhe duke u spostuar. - *Rond de jambe en l'air sauté en dehors en dedans*. - *Grand pas assemble* anash dhe para në e paulement, e marrë nga pozicioni *V* në *pe-passo, pas glissade, sissonne tombe para*. - *Grand pas jete para në attitude croisse në arabesque III,* I, e marrë nga pozicioni V, coupe-passo, pas glissade. - *Grand pas de chat*. - *Grand temps lie sauté para dhe mbrapa*. - *Temps leve në pozen 90*.* - Pas cabriole në 45* para dhe mbrapa - *me coupe-passo ,pas glissade, sissonne tombe*. - *Sissonne simple en tournant en dehors en dedans*.	- realizon lëvizjet e reja që ekzekutohen në kohë muzikore me të shpejtë. - realizon hedhjet në "*battu*" dhe "en tournant". - përvetëson teknikat e hedhjeve të mëdha në vend, të spostuara dhe "*en tournant*".	94 orë

	- *Pas emboitë en tournant* e spostuar anash dhe në diagonal (*4-6).* - *Tours en l'air* duke sjellë këmbën poshtë gjurit, duke mbaruar në pozicionin IV.		

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Për arritjen e nivelit të larta, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko - emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta.
Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij lidhur me programin. Kjo lëndë zhvillohet në grupe (vajza dhe djem) me shoqërim muzikor në piano. Ushtrimet ose lëvizjet duhet t'i përgjigjen programit tematik. Ora e mësimit duhet të ketë kërkesat bazë, si:

- përpikëria në orar;
- përpikëria në uniformë;
- organizmi mbi bazën e logjikës muzikore e teknike;
- renditja dhe organizmi sipas një teknike;
- interpretimi me ndjenjë përbëjnë elementet kryesore të suksesit.

4. Vlerësimi

Mësuesi i lëndës ka të drejtë dhe është kompetencë e tij të realizojë vlerësimin e nxënësit.
Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur interpreton jo korrekt:

- lëvizjet e ushtrimeve;
- renditjen e ushtrimeve;
- teknikën e ushtrimeve;
- shkallën e shpejtësisë së ngadaltë të ekzekutimit.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur interpreton *mirë*:

- teknikisht dhe artistikisht lëvizjet;
- ushtrimet sipas një teknike;
- me një disiplinë të saktë artistike;
- me emocion nëpërmjet nuancave dhe ritmit energjik;
- ushtrimet në levë;
- ushtrimet në mes salle;
- hedhjet;
- puantet.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Repertor skenik**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x1 orë/javë = 35 orë**

1.Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të lëndës " Repertor skenik ", nxënësi:

- njihet me rëndësinë që ka kjo lëndë në formimin e kulturës artistike profesionale të një kërcimtari;
- thellohet në njohjen analitike të repertorit skenik koreografik;
- thellohet në njohjen praktiko-teorike dhe pamore;
- formohet në kohë përmes njohjes së drejtpërdrejtë të repertorit skenik koreografik;
- përvetëson vështirësitë teknike të një vepre koreografike.
- njihet me strukturën e baletit.
- interpreton forma të ndryshme të kërcimit nga baletet klasike.
- transmeton gjendjet e ndryshme emocionale në format e kërcimit të një baleti klasik.

2.Përmbajtja e temave të lëndës "Repertor skenik"

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultatet pritshme**	**orët**
Baleti "Arrëthyesi", ***Tchaikovski Petipa, Ivanov-1892,*** ***nga akti i dytë 'Pas de troi***	- Pjesa e parë - Variacioni i vajzës së parë. - Variacioni i vajzës së dytë. - Variacioni i djalit. - Përsëritje e variacioneve. - Lidhja e "Pas de trois". - Koda	**Nxënësi***:* - njeh teknikisht dhe artistikisht variacionet; - shfrytëzon hapësirën në grup dhe përdor nuancat koreografike gjatë kërcimit.	12 orë
Baleti "Halili dhe Hajria" ***Tish Daija - Panajot Kanaci-1963.*** ***Valle me shamia***	- Prezantimi me veprën. - Hedhja e pjesës së parë. - Punimi i lëvizjeve teknike. - Punimi i nuancave të trupit. - Pastrimi i lëvizjeve. - Lidhja e gjithë veprës. - Koda.	- njeh veprën dhe subjektin e baletit; - realizon teknikisht dhe artistikisht këtë formë kërcimi; - përvetëson shkallën e vështirësisë teknike dhe vë në dukje anën emocionale të veprës.	12 orë

Baleti "Don Kishoti" ***Minkus, Petipa 1869. Nga akti I, skena e 3-të "Toreadorët"***	- Hedhja e pjesës koreografike. - Hyrja e djemve. - Pastrimi i lëvizjeve. - Bashkimi vajza e djem. - Punimi i lëvizjeve teknike. - Koda. - Lidhja e gjithë veprës.	- njeh veprën dhe subjektin e baletit; - realizon teknikisht dhe artistikisht këtë formë kërcimi; - përvetëson shkallën e vështirësisë teknike dhe vë në dukje anën emocionale të veprës.	11 orë

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Përgatitje fizike dhe teknike**
Klasa: **VI, djem**
Kohëzgjatja: **35 javë x 1 orë/javë = 35 orë**

1. Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të mësimit të lëndës "Përgatitje fizike dhe teknike", nxënësi:
- njihet me përmbajtjen e lëndës;
- njihet me rolin e forcës, fleksibilitetit, shkathtësisë, koordinimit dhe artikulimit trupor në teknikën e kërcimit;
- përvetëson dhe respekton lidhjen midis fiziologjisë dhe kërcimit;
- përvetëson, identifikon dhe shpjegon mundësitë dhe kufizimet e trupit të njeriut;
- realizon *ushtrimet të ndryshme për rritjen cilësore të potencialit performues dhe realizimit teknik të lëvizjeve të kërcimit;*
- thellohet në rritjen e ndërgjegjësimit të trupit;
- zhvillon kuptimin e trupit të tij dhe lëvizjes;
- zhvillon trupin e tij dhe të rrisë kërkesa teknike dhe artistike të lëvizjes trupore.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Përgatitje fizike dhe teknike "

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimroe**	**Rezultatet të pritshme**	**Orët**
Ushtrime për ngrohje	- Ushtrime në një vend për çdo pjesë të trupit. - Ushtrime bazë të mbledhjes, zgjerimit dhe rrotullimit të pjesëve të trupit. - Streching dinamik. - Lëvizje vepruese (ecje, hedhje, kapërcim etj).	**Nxënësi:** - njeh rolin e ngrohjes para mësimit të kërcimit; - **n**jeh dhe realizon ushtrimet e ngrohjes në mënyrë të saktë; - **r**ealizon dhe përshkruan metodat dhe teknikat e sakta të ngrohjes në kërcim; - **s**hpjegon ndryshimin midis strechingut dhe ngrohjes në kërcim; - **r**ealizon saktë ushtrimet e ngrohjes për muskujt e tij duke përdorur ushtrimet bazë të mbledhjes, zgjerimit dhe rrotullimit; - kupton rëndësinë e ngohjes në uljen e dëmtimeve të mundshme fizike gjatë kërcimit.	4 orë
Ushtrime për forcën e muskujve	- Ushtrime për forcimin e shputës dhe të ahillit. - Ushtrime për forcimin e muskujve të këmbës. - Ushtrime për forcimin e	- ekzekuton saktë ushtrimet e dhëna dhe njeh ushtrimet e levës në tokë; - kupton që forca është aftësia e muskulit për të prodhuar forcën maksimale në një rast të caktuar;	7 orë

	muskujve të tazit dhe vitheve. - Ushtrime për forcimin e muskujve të poshtëm të barkut. - Ushtrime për forcimin e muskujve të sipërm të barkut. - Ushtrime për forcimin e muskujve të shpinës dhe duarve. - Ushtrimet përgatitore të levës në tokë.	- kupton që forca muskulare ndihmon muskulin të prodhojë lëvizje të vazhdueshme dhe ndihmon në reduktimin e lodhjes për realizimin e një lëvizjeje të caktuar në kërcim. - ekzekuton lëvizjet teknike të kërcimit duke shpjeguar muskujt përkatës që ndihmojnë në realizimin e saktë të tij.	
Ushtrime për fuqinë muskulare	- Ushtrime të trajnimit plyometrik. - Ushtrime plyometrike për pjesën e poshtme të trupit. - Ushtrime të trajnimit plyometrike për pjesën e sipërme të trupit. - Ushtrime të trajnimit plyometrike për intesitetin e fuqisë së muskulit. - Ushtrime të trajnimit plyometrike për frekuencën e fuqisë së muskulit. - Ushtrime të trajnimit plyometrike për përmirësimin e fuqisë muskulare. - Ushtrime për fuqinë e përgjithshme muskulare.	- ekzekuton dhe kupton lëvizjet e trajnimit plyometrik: *hedhje në pozicion të lirë, hapa të larta, hedhje në qëndrim, hedhje të shumëfishta, hedhjet në kuti etj.;* - *k*upton që fuqia muskulare ndihmon në krijimin e forcës së menjëhershme për realizimin e një lëizje të kërcimit; - kupton që fitimi i fuqisë muskulare ndihmon në përmirësimin e teknikës së hedhjeve dhe të plies; - ekzekuton ushtrimet e trajnimit plyometrike duke kuptuar zhvillimin e vazhdueshëm teknik.	7 orë

Ushtrime për fleksibilitetin	- Ushtrime për fleksibiltetin e pjesës së poshtme të trupit. - Ushtrime për fleksibilitetin e pjesës së sipërme të trupit. - Ushtrime të fleksibilitetit statik - aktiv dhe statik - pasiv. - Ushtrime të fleksibilitetit dinamik me teknikën e qëndrimit, kontraktimit. - Ushtrime për përmirësimin e fleksibilitetit me metodën e çlirimit të tensionit. - Ushtrime strechingu statik dhe dinamik. - Ushtrime të strchingut PNF dhe balistik.	- ekzekuton ushtrimet për përmirësimin e fleksibiliteti të trupit sipas kërkesave të secilit ushtrim; - kupton që përmirësimi i fleksibilitetit të trupit të kërcimtarit është shumë i rëndësishëm për forcën muskulare, për ndërtimin e efiçencës së koordinimit të lëvizjes dhe për të parandaluar dëmtimet fizike gjatë realizimit të lëvizjeve të kërcimit; - kupton llojet e ndryshme të fleksibilitetit dhe shpjegon avantazhet dhe disavantazhet e secilit prej tyre; - njeh ushtrimet më të rëndësishme të përmirësimit të fleksibilitetit dhe i ekzekuton ato në masën dhe kohën e duhur; - realizon dhe kupton ushtrimet e fleksibilitetit që ndihmojnë në kthimin e këmbëve en dehor, për përmirësimin e ngritjeve të këmbëve, për plien dhe për përmirësimin e teknikës së hedhjeve.	7 orë
Ushtrime për koordinimin neuromuskular	- Ushtrime të kërcimit klasik në levë. - Ushtrime të kërcimit klasik në mesin e sallës. - Ushtrime të kërcimit klasik që janë me zhvendosje në hapësirë. - Ushtrime të hedhjeve të vogla dhe të mëdha të kërcimit klasik. - Ushtrime të forcës që ndihmojnë në koordinimin e lëvizjeve. - Ushtrime për përmirësimin e fleksibilitetit që ndihmojnë zhvillimin e koordinimit. - Ushtrime të levës në tokë.	- ekzekuton ushtrimet e kërcimit klasik si demi- plie, battement tendus, battement fondus etj., sipas kërkesave të teknikës së kërcimit klasik dhe duke kuptuar lidhjen e tyre me koordinimin neuromuskular; - kzekuton ushtrimet e levës në tokë sipas kërkesave të veçanta; - ealizon ushtrimet dhe kupton që koordinimi neuromuskular ndikon pozitivisht në nivelin e forcës muskulae, balancës në teknikën e kërcimit klasik dhe në shpejtësinë e lëvizjes.	7 orë

Ushtrime për relaksimin e muskujve	- Përsëritja e disa ushtrimeve të bëra gjatë mësimit, por në formë të thjeshtë dhe pa energji. - Tërheqje e muskujve në levë. - Streching dinamik dhe streching statik i pjesëve të trupit.	- realizon ushtrimet e relaksimit; - kupton rëndësinë e relaksimit të trupit mbas mësimit të kërcimit si një pjesë e rëndësishme e parandalimit të dëmtimeve dhe rritjes së rendimentit të trupit; - kupton dhe ekzekuton të gjitha ushtrimet e kësaj lënde në mënyrë që të rrisë teknikën e këcimit dhe të lëvizjes dhe të kuptojë funksionin e trupit të njeriut gjatë lëvizjes.	3 orë

VIII. Arsimi i mesëm me drejtim të orientuar artistik

1. Programet e lëndëve teoriko-artistike

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Historia e baletit shqiptar**
Klasa: **X**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Histori baleti shqiptar", nxënësi:
- shpjegon *zhvillimin e baletit* në Shqipëri, në gjysmën e dytë të shekullit XX.
- rendit *karakteristikat* e baleteve shqiptare;
- liston *përfaqësuesit dhe veprat* më të njohura të baleteve më të spikatura në artin shqiptar;
- argumenton mbi origjinën e muzikës së baletit, koreografinë dhe tematikën e tyre.

2. Përmbajtja e temave të lëndës "Historia e baletit Shqiptar"

Tematika	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Baleti në gjysmën e dytë të shekullit XX	- Koreografia shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX, vitet 50 -56. - Lëvizja amatore në koreografinë shqiptare përgjatë viteve 50- 90. - Themelimi i Filarmonisë së Shtetit Shqiptar. - Baleti i parë i vënë në skenën tonë "*Shatërvani i Bacisarajt*". - Zhvillimet koreografike (vitet '90). - Dansi dhe baleti shqiptar pas viteve '2000. - "Albania Dance Meeting" - i pari Festival Ndërkombëtar i Dansit modern. - Balerinë shqiptarë të konfirmuar në arenën ndërkombëtare. - "Albania Dance Theater" - e para kompani e dansit kontemporan në Shqipëri.	**Nxënësi:** - njeh zhvillimin e artit koreografik në Shqipëri dhe etapat kryesore të koreografisë shqiptare; - shpjegon zhvillimin e artit koreografik në Shqipëri; - shpjegon zhvillimin e artit koreografik në Shqipëri mbas viteve '90; - vlerëson duke mbajtur qëndrim ndaj veprave dhe zhanerave të reja moderne duke i analizuar ato.	10 orë
Krijimi i institucioneve arsimore dhe artistike	- Krijimi i Teatrit të Operës dhe të Baletit. - Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe i Valleve Popullore. - Shkolla e baletit shqiptar.	- njeh institucionet e para artistike dhe arsimore të baletit; - kupton rolin dhe rëndësinë e këtyre	4 orë

		institucioneve.	
Baleti shqiptar pas viteve 50 - 2000	- Njohja me baletet dhe ekzekutimin e baleteve: *"Fadeta", "Laurencia", "Sherezade"*. - Grupi i të 5-ve dhe baletet " Paganini" dhe "Franceska da Rimiwi". - Baleti i parë shqiptar "Halili dhe Hajria". - Baleti "Delina". - Baleti "Cuca e Maleve". - Baleti " Tokë e pamposhtur". - Baleti "Shota e Azem Galica". - Baleti "Plaga e 10-të e Gjergj Elez Alisë".	- analizon veprat (baletet) kombëtare; - kategorizon baletet sipas periudhave; - përcakton tematikën në balete të ndryshme: me temë historike, me temë shoqërore, me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, me temë bashkëkohore, me temë përralle.	10 orë
Përfaqësuesit e baletit shqiptar	4.1. Panajot Kanaçi, babai i koreografisë shqiptare. 4.2. Agron Aliaj, balerini dhe koreografi me kontribute të mëdha. 4.3. Baleti shqiptar i Kosovës. 4.4. Angjelin Preljocaj, koreografi me origjinë shqiptare. 4.5. Yjet e baletit shqiptar përgjatë viteve '60-'90.	- flet për jetën dhe veprat e krijuara nga përfaqësuesit e koreografisë shqiptare; - analizon duke krahasuar dy vepra nga koreografë të ndryshëm.	10 orë

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Historia e baletit botëror**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Histori baleti", nxënësi:

- shpjegon *zhvillimin historik të baletit nga fillimet e saj deri në shekullin XVI;*
- shpjegon *karakteristikat* e çdo periudhe;
- liston përfaqësuesit dhe veprat më të njohura që ata përfaqësojnë për çdo periudhë;
- analizon *risitë e reformave* në kërcim sipas përfaqësuesve të çdo periudhe;
- shpjegon *zhvillimin historik të* baletit *në Evropë;*
- njeh përfaqësuesit dhe veprat koreografike më të njohura në artin botëror .

2. Përmbajtjet e tematike të lëndës "Historia e baletit botëror"

Tematika	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Dansi dhe baleti	- Kërcimi si gjuha e trupit. - Burimet materiale të kërcimit. - Elementet dhe parimet themelore të kërcimit. - Kërcimi, natyra dhe shoqëria.	**Nxënësi:** - njeh elementet dhe parimet e kërcimit; - emërton parimet themelore të kërcimit; - shpjegon lidhjen e kërcimit me njeriun dhe natyrën.	4 orë
Periudha parahistorike	- Kërcimi parahistorik. - Kërcimi në Egjiptin e lashtë dhe në Orientin e largët.	- njeh zhvillimin e kërcimit në periudhën parahistorike; - shpjegon ndryshimet e kërcimeve në vendet e Orientit të largët; - emërton llojet e kërcimeve parahistorike.	2 orë
Kërcimi në botën antike	- Kërcimi në periudhën e antikitetit grek. - Llojet e kërcimeve në Greqinë antike - Kërcimi në periudhën e Romës antike. - Llojet e kërcimeve në Romën antike	- njeh kulturën e botës antike; - emërton llojet e kërcimeve në këtë periudhë dhe ndryshimet e tyre.	4orë

Kërcimi në periudhën e Mesjetës	- Paganizmi dhe kristianizmi. - Mesjeta dhe kërcimi. - Kërcimi fetar dhe i shenjtë. - Kërcimet e oborrit. - Llojet e kërcimeve.	- njeh zhvillimet e epokës në art dhe në kërcim në veçanti; - emërton kërcimet fetare dhe ato të oborrit; - shpjegon ndryshimin e kërcimit nga antikiteti në mesjetë.	5 orë
Rilindja Evropiane	- Rilindja Evropiane dhe kërcimi. Humanizmi. - Studimi mbi kërcimin, struktura dhe teoria. - Kërcimi i oborrit. - Kërcimet e ulëta dhe të larta. - Llojet e kërcimeve. - Kërcimtarët e oborrit. - Kërcimi në Francë. - Kërcimi në Spanjë dhe në Itali.	- njeh llojet e kërcimeve dhe ndryshimet midis tyre; - emërton kërcimet dhe strukturat e tyre; - shpjegon idenë e humanizmit dhe ndikimin e saj në kërcim.	8 orë
Kërcimi dhe baleti në shekullin XVI	- Kërcimi social në Evropë në vitin 1500. - Kërcimi social në Itali. - Kërcimi social në Francë. - Ballot dhe baleti në traktatin e Karozos dhe të Negrit. - Komedia del Arte. - Artistët e *Komedia del Arte.* - Lindja e baletit në oborrin italian. - Baleti në oborrin francez. - Baleti i parë - Baltazar. - Baleti i maskave dhe i antimaskave në Angli. - Koreografët dhe teoricienët e epokës.	- njeh kërcimin dhe baletin në shekullin XVI; - emërton baletet, koreografët teoricienët dhe kërcimtarët e shekullit. - shpjegon ndryshimet që pësoi kërcimi në këtë periudhë dhe stilin e epokës.	11 r ë

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Rekomandime për kërkime të tjera nëpërmjet internetit përgjatë një (1) viti shkollor:

- Kërkime nëpërmjet internetit të informacioneve më të thelluara për vepra skenike.
- Kërkime për njohjen më të mirë të kërcimit në parahistori dhe antikitet nëpërmjet zbulimeve arkeologjike .
- Kërkime në galeri arti për lidhjen e arteve të bukura me kërcimin.

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit:

- Prezantimi dhe ilustrimi me DVD gjatë procesit mësimor i baleteve të përfshira në program.
- Shikim i shfaqjeve të baletit në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare të dansit në vendin tonë.

4. Vlerësimi

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- shpjegon *shumë qartë* zhvillimin e artit koreografik botëror dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme;
- analizon *shumë saktë* veprat (baletet) botërore;
- kategorizon *saktë* baletet sipas periudhave;
- përcakton *saktë* gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo demiklasik;
- vlerëson *saktë* duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja koreografike.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- shpjegon zhvillimin e artit koreografik botëror dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme;
- analizon veprat (baletet) botërore;
- kategorizon baletet sipas periudhave;
- përcakton gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo demiklasik dhe modern;
- vlerëson duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja koreografike.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- shpjegon *me vështirësi* zhvillimin e artit koreografik dhe përcakton *me vështirësi* etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme;
- analizon *me vështirësi* veprat (baletet) botërore;
- kategorizon *me vështirësi* baletet sipas periudhave;
- përcakton *me vështirësi* gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo modern;
- vlerëson *me vështirësi* duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Historia e baletit botëror**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Histori baleti botëror", nxënësi:

- shpjegon zhvillimin historik të baletit botëror;
- shpjegon karakteristikat e çdo periudhe;
- liston përfaqësuesit dhe veprat më të njohura që ata përfaqësojnë për çdo periudhë;
- analizon risitë e reformave në balet sipas përfaqësuesve të çdo periudhe;
- shpjegon zhvillimin historik të baletit në Evropë;
- liston përfaqësuesit dhe veprat më të njohura që ata përfaqësojnë në artin botëror .

2. Përmbajtjet e tematike të lëndës "Historia e baletit

Tematika	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Baleti, kërcimi social dhe teatral në shekullin e XVII	- Repertori koreografik dhe muzikor në vitet e para të shekullit XVII. - Kërcimi dhe gjesti në melodramat e fillimeve tnë viteve 1600. Baleti Melodramatik. - Baleti i oborrit në Francë. Baleti Maskarade dhe Melodramatik. - Baleti dhe kërcimi aristokrat në oborrin e Mbretit të Diellit. - Epoka e Luli dhe Molierit. - Krijimi i Akademisë Mbretërore të Kërcimit dhe lindja e koreografisë. - Kërcimi teatral në Itali dhe Francë.	***Nxënësi:*** - njeh repertorin koreografik të epokës; - emërton kërcimet oborrtare në Itali dhe në Francë; - shpjegon ndryshimet midis kërcimeve dhe baleteve në Itali dhe në Francë dhe nevojën që çoi në krijimin e akademisë së kërcimit.	5 orë
Baleti në fund të shekullit XVII dhe fillim të shekullit XVIII	- Kërcimi në Operan e Parisit nga koha e Luigjit XIV deri në kohën e Luigjit XV. - Prezantimi dhe afirmimi i kërcimit francez në Europë. - Kërcimi Italian në Itali dhe në Perëndim. - Baleti anglez. - Rizbulimi i teatrit antik në fillim të shekullit. - Kërcimi kundrejt komunikimit ekspresiv.	- njeh kërcimet evropiane të periudhës; - emërton artistët që influencuan në zhvillimin e këtij arti skenik në Evropë; - shpjegon ndryshimet midis kërcimeve italiane me ato franceze dhe ndikimin që patën ato në zhvillimin e njëri – tjetrit.	5 orë
Baleti në gjysmën e parë	- Koreografët, artistët e baletit dhe kompozitorët e baleteve në	- njeh koreografët dhe artistët e baletit;	6 orë

të shekullit të XVIII. **Reformat e Hilverding deri në " Pre- baletin veprues"**	Evropë. - Ramo dhe akademizmi i baletit. - Estetika e shfaqjeve franceze. - Reformat e Hilverding në Vienë. Baletet e tij. - Kërcimi në Itali. "Baleti i Pantomimës" i Jean – Baptiste de Hesse. - Pre- baletet veprues në Francë	- emërton reformat dhe risitë që ndodhën në balet; - shpjegon çfarë është baleti i pantomimës dhe ai veprues.	
Epoka e Noverit	- Debati estetik. Kërcimi si një art imitimi. - Reformat e Jean – Georges Noverre. - Baletet dhe bashkëpunëtorët e Noverit. - Reforma e Gasparo Angiolini. Baletet e tij. - Polemikat midis Angiolinit dhe Nover. - Evolimi i teknikës akademike franceze. - Reforma e dytë në baletin francez. - Jean Dauberval dhe baletet e tij.	- njeh zhvillimet estetike që ndodhën në artin e baletit; - emërton reformat e Noverre dhe Angiolini; - shpjegon ndryshimin e reformatorëve dhe si i aplikuan ato idetë e tyre në veprat që krijuan.	8 orë
Baleti pre-romantik	- Koha dhe stili i kërcimit francez. Baletet pre- romantike. - Karlo Blasis, teoricien i baletit pre - romantik. - Kërcimi italian midis neoklasicizmit dhe romantizmit. - Koreodrama e Salvatore Vigano. Baletet e tij. - Sharl Lui Didlo dhe baletet e tij pre - romantike.	- njeh repertorin koreografik të epokës dhe stilin e tyre; - emërton baletet dhe artistët më me influencë të periudhës; - shpjegon se çfarë është baleti pre – romantik dhe cfarë ndikimi pati kjo rrymë në zhvillimin e artit të baletit dhe kërcimit.	6 orë
Baleti romantik	- Ëndrra dhe realiteti i baletit romantik. - Koreografët, kompozitorët dhe balerinët e roamntizmit. - Baletet romantike. Veçoritë e tyre. - Baleti romantik në Francë, Danimarkë dhe Itali. - Baleti "Silfidë", "Zhizel", "Korsar"	- *njeh* romantizmin si rrymë në art dhe veçoritë e baletit romantik; - *emërton* baletet romantike, koreografët kompozitorët dhe balerinët e romantizmit; - *shpjegon* ndryshimet që pësoi baleti në periudhën e romantizmit dhe arsyen e këtyre ndryshimeve.	5 orë

Baleti evropian në gjysmën e dytë të shekullit të XIX	- Baleti francez, anglez. - Baleti italian, danez.	- njeh zhvillimin e baletit evropian mbas romantizmit; - shpjegon ndryshimet që pësoi baleti.	2 orë
Baleti rus në shekullin XIX	- Charl Didlo në formimin e teatrit të baletit rus. Romantizmi në baletin rus. - Artur Sen – Leon dhe reformii i baletit rus. - Marius Petipa dhe teatri i baletit në gjysmën e dytë të shekullit XIX. - Lindja e baletit simfonik. - Artistët më të mirë të baletit rus. - Baletet *"Arrëthyesi", "Liqeni i Mjellmave","Bukuroshja e Fjetur", " E bija e faraonit", " Rajmonda".*	- njeh zhvillimin e baletit në rusi në shekullin XIX; - emërton koreografët, baletet, kompozitorët dhe balerinët e shek. XIX; - shpjegon risitë e baletit simfonik dhe mënyrën e ndërtimit të këtyre baleteve.	7 orë
Ritmi dhe plastika e kërcimit në fillim të shekullit XX	- Kërcimi i lirë. Forma estetike e tij. - Pionerët Americanë të kërcimit të lirë: *Loie Fulle, Ruth St. Denis, Isadora Dunkan.* - Kërcimi i lirë Europian: *Emile Jaques – Dalcroze, Rudolf Laban.* - Kërcimi ekspresionit gjerman: *Mary Ëigman, Kurt Joos.*	- njeh zhvillimin e kërcimit të lirë dhe formën e tij; - emërton koreografët dhe nëwdarjet e ndryshme të kërcimit të lirë; - shpjegon rrethanat e krijimit të kërcimit të lirë dhe ndryshimet e tij në vende të ndryshme;	4 orë
Sezonet ruse	- Sezonet ruse dhe S. Djailjev. Sezoni i parë rus. - Koreografi M.Fokin dhe baletet e tij në sezonin e parë. - Sezoni i dytë rus. Artistët më të rëndësishme të këtij sezoni. - Koreografët e sezonit të dytë dhe baletet e tyre më të rëndësishme. - Sezoni i tretë rus. Artistët më të rëndësishëm të këtij sezoni. - Koreografët e sezonit të tretë dhe baletet e tyre më të rëndësishme.	- njeh rëndësinë që patën sezonet ruse në baletin botëror; - emërton koreografët, balerinët dhe baletet e sezonit rus; - shpjegon ndryshimet që pësoi arti koreografik dhe teknika e tij në sezonet ruse.	6 orë
Baleti në Europë dhe Amerikë në shekullin e XX	- Baleti në Francë. - Baleti në Angli. - Baleti në Amerikë. - Forma e reja të kërcimit akademik.	- njeh zhvillimin e baletit europian dhe atij amerikan në shekullin XX; - emërton koreografët dhe nëwdarjet e ndryshme të	5 orë

	- Baleti modern në Evropë dhe në Amerikë	baletit në këtë shekull. - shpjegon rrethanat e krijimit të baletit modern në botë dhe format e reja të kërcimit akademik.	
Kërcimi modern	- Kërcimi modern në Amerikë: *Martha Graham, Jose Limon, Doris Humphrey*. - Kërcimi xhaz dhe pionierët e tij në Amerikë. - Avangardët e rinj amnerikanë: *Aw Halprin, Merce Cuwingham, Murray Louis.*	- njeh zhvillimin e kërcimit modern dhe format e tij; - emërton koreografët dhe nëwdarjet e ndryshme të kërcimit të modern; - shpjegon rrethanat e krijimit të kërcimit modern.	3 orë
Baleti në ish BRSS	- Arritjet e baletit sovjetik nga revolucioni deri në vitet ’60. - Artistët më të mirë të artit koreografik sovjetik. Baletet më të rëndësishme. - Tiparet e koreografisë sovjetike dhe arritjet e reja mbas viteve ’60.	- njeh zhvillimin e artit koreografik sovjetik dhe format e reja të baletit; - emërton koreografët, balerinët, baletet e baletit sovjetik; - shpjegon format e baletit sovjetik dhe mënyrën e ndërtimit të tyre.	3 orë
Kërcimi kontemporan	- Kërcimi post modern. - Danc teatër. *Pina Bausch*. - Kërcimi i ri: *Angli, Francë*	- njeh zhvillimin e kërcimit postmodern, danc teatrit dhe kërcimit të ri; - emërton koreografët dhe baletet më të rëndësishme të tyre; - shpjegon ndryshimet e kërcimeve postmoderne dhe veçantitë e secilit koreograf.	3 orë

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Rekomandime për kërkime të tjera nëpërmjet internetit përgjatë një (1) viti shkollor:

- Kërkime nëpërmjet internetit të informacioneve më të thelluara për vepra skenike.
- Kërkime për njohjen më të mirë të kërcimit në parahistori dhe antikitet nëpërmjet zbulimeve arkeologjike .
- Kërkime në galeri arti për lidhjen e arteve të bukura me kërcimin.

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit:

- Prezantimi dhe ilustrimi me DVD gjatë procesit mësimor i baleteve të përfshira në program.

- Shikim i shfaqjeve të baletit në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare të dansit në vendin tonë.

4. Vlerësimi

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:
- shpjegon *shumë qartë* zhvillimin e artit koreografik botëror dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme;
- analizon *shumë saktë* veprat (baletet) botërore;
- kategorizon *saktë* baletet sipas periudhave;
- përcakton *saktë* gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo demiklasik;
- vlerëson *saktë* duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja koreografike.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:
- shpjegon zhvillimin e artit koreografik botëror dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme;
- analizon veprat (baletet) botërore;
- kategorizon baletet sipas periudhave;
- përcakton gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo demiklasik dhe modern;
- vlerëson duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja koreografike.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:
- shpjegon *me vështirësi* zhvillimin e artit koreografik dhe përcakton *me vështirësi* etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme;
- analizon *me vështirësi* veprat (baletet) botërore;
- kategorizon *me vështirësi* baletet sipas periudhave;
- përcakton *me vështirësi* gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo modern;
- vlerëson *me vështirësi* duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Histori muzike**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Histori muzike", nxënësi:

- njeh zhvillimin e muzikës në periudhën e Lashtësisë, Mesjetës, Rilindjes, si dhe karakteristikat e tyre;
- njeh kompozitorët e çdo periudhe, jetën dhe veprat e tyre;
- kupton vendin që ka zënë muzika në jetën shpirtërore të njerëzimit;
- plotëson formimin artistik profesional të balerinëve me periudhat e zhvillimit muzikor;
- edukon veshin muzikor nëpërmjet literaturës klasike;
- zhvillon aftësitë për të kuptuar, shijuar dhe vlerësuar veprat muzikore;
- njeh zhvillimin e muzikës instrumentale në periudhën e barokut, si dhe karakteristikat e saj;
- dallon format e mëdha vokale që u zhvilluan në këtë periudhe;
- flet mbi karakteristikat kryesore të periudhave (romantizmi);
- flet rreth risive në secilën periudhë muzikore;
- evidenton veprat muzikore dhe flet për përfaqësuesit e muzikës.

2. Përmbajtjet e tematike të lëndës "Historia e muzikës"

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Muzika në Lashtësi, Mesjetë, Rilindje	- Kultura muzikore te popujt e lashtë. - Kultura muzikore në periudhën e Mesjetës. - Periudha e Rilindjes. Rëndësia e saj. - Shkollat polifonike flamande e italiane. - Lindja e operas.Opera në Itali. - Opera në Francë. - Opera në Angli. - Opera në Gjermani.	**Nxënësi:** - njeh zhvillimin e kulturës muzikore në Lashtësi, Mesjetë dhe në Rilindje, si dhe karakteristikat e tyre; - njeh lindjen e operës.	9 orë
Paraklasicizmi	- Muzika instrumentale në shekujt XVII - XVIII (Koreli,Vivaldi). - Literaturë muzikore: *Stinët e vitit – Vivaldi; J.S.Bach; Prelude e fuga Bach.* - Tokata dhe fuga në re. - Zh.F.Hendel. - Arti muzikor gjatë shekullin XVIII. Opera "Bufa". - Gluku dhe reforma e tij.	- njeh zhvillimin e muzikës instrumentale në shekujt XVII, XVIII; - dëgjon veprat me kryesore të kompozitorëve të kësaj periudhe.	8 orë

	- Operat e Glukut.		
Klasicizmi	- Muzika instrumentale në shekullin XVIII, J.Hajden, simfoni Hajden në re. - Jeta dhe krijimtaria e Moxartit. - Vepra muzikore nga Moxart. - Simfonia në sol. - Jeta dhe krijimtaria e Bethovenit. - Simfonizmi i Bethovenit. - Sinfonia nr. 3 heroike. - Simfonia nr.5 e fatit. - Simfonia nr.9 heroike.	- njeh kompozitorët kryesorë, si: Hajden, Moxart, Bethoven; - dallon risitë që sollën në gjininë e operës dhe të simfonisë. - njeh dhe dëgjon veprat më të rëndësishme të këtyre kompozitorëve.	14 orë
Romantizmi	- Romantizmi në muzikë. - Jeta dhe krijimtaria Ëeberit (Gjahtari i lirë). - Jeta dhe krijimtaria e Shubertit (sinfonia e pambaruar në *si*). - Jeta dhe krijimtaria e R.Shuman (uvertura "Manfred"). - Jeta dhe krijimtaria F. Mendelson (uvertura "Ëndrra e një nate vere". - Jeta dhe krijimtaria e Shopenit. - Veçoritë e stilit të Shopenit në veprat per piano (etyde,skerco, mazurkat,valset, polonezet). - Opera italiane në gjysmën e parë të shekullit XIX *(Paganini, Rosini).* - Opera italiane në gjysmën e parë të shekullit XIX (*Belini, Donixeti).* - Uvertura nga opera të Rosinit dhe të Belinit. - Uvertura nga operat e Donixetit. - Jeta dhe krijimtaria e Hektor Berlioz. Demokratizimi dhe programatizmi i simfonisë së tij. - Sinfonia fantastike e Berliozit. - Uverturat e Berliozit. - Jeta dhe krijimtaria F. List. - Poemat simfonike të Listit. - Jeta dhe krijimtaria J.Brahms. - Rapsoditë e Brahmsit. - Jeta dhe krijimtaria e Xhuzepe Verdit. - Uverturat nga operat e Verdit. - Jeta dhe krijimtaria Bedrzhih	- njeh periudhën më prodhimtare dhe më të rëndësishme; - njeh përfaqësuesit kryesorë të shkollave krijuese kombëtare evropiane; - njeh dhe dëgjon veprat kryesore instrumentale, simfonike dhe operistike të këtyre kompozitorëve.	37 orë

	Smetana. - Cikli simfonik “Atdheu im”. - Jeta dhe krijimtaria Antonio Dvorzhak. - Simfonia “Bota e re”nr 5.		

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Rekomandime për kërkime të tjera nëpërmjet internetit përgjatë një viti shkollor:

- Kërkime nëpërmjet internetit të informacioneve më të thelluara për jetën dhe për krijimtarinë e kompozitorëve të periudhave të ndryshme.
- Kërkime në bibliotekën kombetare për literaturë të ndryshme.

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit:

- Prezantimi dhe ilustrimi me CD gjatë procesit mësimor i kryeveprave të kompozitorëve.
- Shikim i shfaqjeve të baletit në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare në vendin tonë.

4. Vlerësimi

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- shpjegon *saktë* karakteristikat e periudhave të zhvillimit muzikor;
- përcakton *shumë mirë* tematikat e veprave dhe veçoritë e kompozitorëve.
- përcakton *saktë* rëndësinë e studimit të lëndës së historisë së muzikës;
- analizon *saktë* individualitetin krijues të çdo kompozitori;
- shpjegon *natyrshëm* lidhjen e baletit dhe të muzikës.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- shpjegon *mirë* karakteristikat e periudhave të zhvillimit muzikor;
- përcakton *mirë* tematikat e veprave dhe veçoritë e kompozitorëve.
- përcakton *mirë* rëndësinë e studimit të lëndës së historisë së muzikës;
- analizon *mirë* individualitetin krijues të çdo kompozitori;
- shpjegon *mirë* lidhjen e baletit dhe të muzikës.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- shpjegon *jo mirë* karakteristikat e periudhave të zhvillimit muzikor;
- përcakton *mjaftueshëm* tematikat e veprave dhe veçoritë e kompozitorëve.
- përcakton *mjaftueshëm* rëndësinë e studimit të lëndës së historisë së muzikës;
- analizon *mjaftueshëm* individualitetin krijues të çdo kompozitori;
- shpjegon *mjaftueshëm* lidhjen e baletit dhe të muzikës.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Histori muzike**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Histori muzike", nxënësi:

- njeh zhvillimin e muzikës në periudhën e *shekullit XIX*;
- evidenton veprat dhe kompozitorët e periudhave të marra në studim;
- kupton vendin që ka zëne muzika në jetën shpirtërore të njerëzimit;
- *plotëson* formimin e vet artistik dhe muzikor;
- zhvillon aftësitë për të kuptuar, shijuar dhe vlerësuar veprat muzikore;
- njeh muzikën moderne;
- njeh veprat dhe muzikën profesioniste shqiptare;
- dëgjon dhe argumenton veprat e kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj.

2. Përmbajtjet e tematike të lëndës "Historia e muzikes"

Tematika	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Muzika në shekullin XIX	- M.Glinka. Jeta dhe krijimtaria. - Uvertura nga operat e Glinkes. - Çajkovski. Jeta dhe krijimtaria. - Koncerti për piano dhe orkestër. - Muzika e baleteve të Çajkovskit "Bukuroshja e fjetur". - Baleti"Arrëthyesi". - Baleti"Liqeni i mjelmave". - Xhakomo Puçini. Jeta, krijimtaria. - Uverturë nga operat e tij. - R.Vagner.Jeta,krijimtaria. - Uverturë nga operat e tij. - Zh.Bize. Jeta dhe krijimtaria. - Literaturë, uverturë nga opera "Karmen". - Suitë orkestrale "Arleziana". - E. Grig. Jeta dhe krijimtaria. - Koncerti për piano dhe orkestër. - Suita vokalo-simfonike "Per Gynt". - S.Rahmaninov. Jeta dhe krijimtaria. - Koncerti për piano dhe orkestër nr.2. - Prokofiev. Krijimtaria	**Nxënësi:** - njeh përfaqësuesit e shkollave krijuese kombëtare ruse; - shpjegon të rejat që solli Çajkovski në gjininë e operas dhe sidomos baletit; - njeh krijimtarine e karakteristikat e grupit të të pestëve; - njeh dhe dëgjon kryeveprat e tyre.	32 orë

	instrumentale dhe simfonike. - Vepra për piano dhe simfonia klasike e tij. - Grupi i të pestëve në Rusi: Musorgski, Balakiriev, Rimski-Korsakov, Borodin, Cezar - Kui. - Valse Balakiriev dhe simfonia e Borodinit. - Tablo nga ekspozita Musorgski. - Suite orkestrale "Shehrazade" e Rimski-Korsakov.		
Postromantizmi dhe muzika e shekullit XX	- Familja Shtraus, krijimtaria. - Valset Shtraus. - Polka Shtraus. - Simfonia alpine. - Poema simfonike. - Periudha e postromantizmit. - Gustav Maler krijimtaria e tij. - Simfonia nr.7 klasike. - Muzikë moderne.M.Ravel.Jeta dhe krijimtaria. - Bolero" e Ravelit.	- shpjegon karaktistikat e muzikës postromantike; - evidenton veprat dhe kompozitorët; - shpjegon karakteristikat e muzikës së shekullit XX.	17 orë
Muzika shqiptare	- Vështrim i pergjithshëm mbi zhvillimin e muzikës shqiptare. - Zhvillimi i muzikës operistike shqiptare. - Uvertura dhe arie nga operat shqiptare. - Muzika simfonike shqiptare. - Simfonia e Ç.Zadeja nr.1. - Simfonia e Limoz Dizdarit. - Muzika e baleteve shqiptare - Muzikë nga baletet shqiptare. - Muzika instrumentale shqiptare. - Koncerte per piano dhe orkestër (Ç.Zadeja). - Koncerte për piano dhe orkestër (T.Harapi dhe F. Ibrahimi). - Koncert për violinë e orkestër (P. Gaci dhe N. Zoraqi). - Valle simfonike Th.Gaqi, F.Deda, F. Ibrahimi dhe A. Peci. - Uvertura festive N.Zoraqi dhe P.Vorpsi. - Zhvillimi i këngës shqiptare,	- njeh zhvillimin e muzikës shqiptare, operistike, simfonike, instrumentale; - njeh zhvillimin e baletit shqiptar dhe evoluimin që ka pësuar kjo gjini; - njeh dhe degjon veprat më të mira të kompozitorëve tanë.	19 orë

	romancat, baladat dhe këngët masive dhe këngët për fëmijë.		

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Rekomandime për kërkime të tjera nëpërmjet internetit përgjatë një viti shkollor:

- Kërkime nëpërmjet internetit të informacioneve më të thelluara për jetën dhe për krijimtarinë e kompozitorëve të periudhave të ndryshme.
- Kërkime në bibliotekën kombetare për literaturë të ndryshme.

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit:

- Prezantimi dhe ilustrimi me CD gjatë procesit mësimor i kryeveprave të kompozitorëve.
- Shikimi i shfaqjeve të baletit në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare në vendin tonë.

4. Vlerësimi

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- shpjegon *saktë* karakteristikat e periudhave të zhvillimit muzikor;
- përcakton *shumë mirë* tematikat e veprave dhe veçoritë e kompozitorëve.
- përcakton *saktë* rëndësinë e studimit të lëndës së historisë së muzikës;
- analizon *saktë* individualitetin krijues të çdo kompozitori;
- shpjegon *natyrshëm* lidhjen e baletit dhe të muzikës.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- shpjegon *mirë* karakteristikat e periudhave të zhvillimit muzikor;
- përcakton *mirë* tematikat e veprave dhe veçoritë e kompozitorëve.
- përcakton *mirë* rëndësinë e studimit të lëndës së historisë së muzikës;
- analizon *mirë* individualitetin krijues të çdo kompozitori;
- shpjegon *mirë* lidhjen e baletit dhe të muzikës.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- shpjegon *jo mirë* karakteristikat e periudhave të zhvillimit muzikor;
- përcakton *mjaftueshëm* tematikat e veprave dhe veçoritë e kompozitorëve.
- përcakton *mjaftueshëm* rëndësinë e studimit të lëndës së historisë së muzikës;
- analizon *mjaftueshëm* individualitetin krijues të çdo kompozitori;
- shpjegon *mjaftueshëm* lidhjen e baletit dhe të muzikës.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Folklor koreografik**
Klasa: **X**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Folklor koreografik", nxënësi:

- njeh vallet popullore shqiptare;
- evidenton *ritmet e përziera* folklorike.;
- dallon vallet folklorike shqiptare, ndërtimin e tyre dhe krahinën që i përkasin;
- njeh kostumet e valleve shqiptare dhe i ndan ato sipas trevave;
- analizon zhvillimin e folklorit koreografik në tërësinë e tij dhe në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse sipas trevave;
- gjen shembuj të thjeshtë koreografikë përmes *ritmeve*, duke shpjeguar ndërtimin e tyre;
- argumenton karakteristikat e valleve, duke komentuar vlerat e tyre folklorike;
- mban qëndrim personal, duke sjellë shembuj konkretë të folklorit koreografik nga treva të ndryshme;
- bën kërkime të ndryshme për materiale në bazë të temave.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Folklor koreografik"

Tematika	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi	- Ndarja etno-koreografike. - Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi. - Lirika kombëtare e pasqyruar në valle sipas trevave etnike. - Tematikat specifike të fushave që përmbajnë gjininë në koreografi - Karakteri i valles lirike shqiptare. - Emërtimi shqiptar *valle.* - Forca ndikuese e valles sonë në vendet fqinje. - Strukturat e ndërtimit arkitektonike të valles lirike shqiptare. - Format e kërcimit popullor. - Specifika e shoqërimit muzikor në valle.	**Nxënësi:** - shpjegon shtrirjen etno-koreografike të folklorit shqiptar; - njeh karakterin e lirikës së valleve shqiptare; - analizon format e kërcimit popullor.	15 orë

Vallet e punës	- Vallet e gjuetisë. - Vallet e prodhimtarisë. - Vallet e zanatit.	- njeh vallet e punës dhe karakteristikat e tyre; - kupton pse shërbyen punët në koreografi dhe zanatet specifike që janë zhvilluar në vallet tona.	6 orë
Koreografia erotike	- Vallet e dashurisë		4 orë
Vajtimet në koreografi	- Vallet mortore labe. - Gjama e vdekjes.	- zhvillon njohuritë përmes ritmeve, karaktereve dhe interpretimit të valleve.	5 orë
Komikja ne koreografi	- Vallet humoristike. - Valle groteske. - Vallet satirike	- analizon lirikën dhe vallet shqiptare dhe rëndësinë që kanë ato.	5 orë
Koreografia rituale	- Vallet rituale pagane. - Vallet rituale kristiane. - Vallet rituale te dasmave.	- analizon ndikimin e ritualeve në vallet tona shqiptare.	5 orë
Epika në koreografi	- Vallet e rënda. - Vallet dyshe - Vallet treshe	- analizon epikën dhe vallet shqiptare dhe rëndësinë që kanë ato.	15 orë
Valle të ndërthurura	- Vallet bishtore te Labinotit (valle liriko-epike). - Vallet e rënda malësore.	- analizon vallet shqiptare, karakterin dhe rëndësinë që kanë ato.	5 orë

3. Vlerësimi

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:
- gjen *saktë* në shembujt e ndryshëm koreografikë, llojin të cilit i përket vallja;
- nalizon *qartë dhe saktë* zhvillimin e folklorit koreografik në tërësinë e tij dhe në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse, si: *karakterin, mënyrat e të kërcyerit sipas llojeve, ritmet, kostumet popullore* që përbëjnë folklorin tonë koreografik;
- gjen në mënyrë të *saktë* shembujt folklorikë koreografikë përmes interpretimit, ritmeve, melodive, karaktereve, duke shpjeguar *qartë* rrugët e krijimit;
- zhvillon aftësi të *sakta* duke rritur interesin në vallet folklorike, si dhe duke shpjeguar *saktë* tiparet e valleve, karakterin folklorik etj.;
- trajton *saktë* vlerat e folklorit koreografik;
- jep shpjegime të *sakta*, duke sjellë shembuj konkretë të folklorit koreografik nga treva të ndryshme.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur***:***
- gjen në shembujt e ndryshëm koreografikë, llojin të cilit i përket vallja;
- analizon zhvillimin e folklorit koreografik në tërësinë e tij dhe në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse, si: *karakterin, mënyrat e të kërcyerit sipas llojeve, ritmet, kostumet popullore* që përbëjnë folklorin tonë koreografik;
- gjen shembuj folklorikë koreografikë përmes interpretimit, ritmeve, melodive, karaktereve, duke shpjeguar rrugët e krijimit.

- zhvillon aftësitë duke rritur interesin në vallet folklorike, si dhe duke shpjeguar tiparet e valleve, karakterin folklorik etj.;
- trajton vlerat e folklorit koreografik;
- jep shpjegime duke sjellë shembuj konkretë të folklorit koreografik nga treva të ndryshme.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur***:***

- gjen ndonjëherë në shembujt e ndryshëm koreografikë, llojin të cilit i përket vallja;
- analizon rrallë zhvillimin e folklorit koreografik në tërësinë e tij dhe në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse, si: *karakterin, mënyrat e të kërcyerit sipas llojeve, ritmet, kostumet popullore* që përbëjnë folklorin tonë koreografik;
- gjen rrallëherë shembuj folklorikë koreografikë përmes interpretimit, ritmeve, melodive, karaktereve, duke shpjeguar rrugët e krijimit;
- zhvillon aftësitë duke rritur interesin në vallet folklorike, si dhe duke shpjeguar tiparet e valleve, karakterin folklorik etj.;
- trajton rrallëherë vlerat e folklorit koreografik.

3. Programet e lëndëve praktiko- artistike dhe të specialitetit

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Ushtrime të karakterit botëror**
Klasa: **X**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të lëndës "Ushtrime të karakterit botëror", nxënësi:

- njihet me përmbajtjen e lëndës;
- realizon lëvizjet në karaktere të ndryshme botërore, si p.sh., *battement tendu* në karakter rus, polak etj.;
- realizon kërcimet e karakterit popullor dhe akademik të popujve të ndryshëm;
- realizon *ushtrimet me lëvizje të ndryshme;*
- realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjet;
- performon secilin ushtrim në karakterin e përcaktuar nga mësuesi;
- krijon ndjeshmërinë ndaj karaktereve, stileve dhe mënyrave të kërcimeve të karakterit botëror;
- zhvillon teknikën e kërcimit, muzikalitetin dhe kërcyeshmërinë.

Kjo lëndë zhvillohet në dy grupe.

2. Përmbajtjet e tematike e lëndës "Ushtrimet e karakterit botëror"

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultatet t pritshme**	**Orët**
Ushtrime në levë	- Pozicionet e këmbëve dhe duarve. - Gjysmë uljet dhe uljet e plota (demi – plie dhe grand plie). - Rrëshqitja e këmbës në tokë (battemet tendus). - Hedhjet e vogla të këmbës (Battement tendus jetes). - Rond de jambe parter. - Battement fondu. - Pas tortille. - Passe retire. - Battement developpe me shtesë rrahjen e thembrës së këmbës së mbështetjes. - Flick- flack e kombinuar me tip – top.	**Nxënësi:** - ekzekuton : • 5 pozicionet e hapura të këmbëve; • 5 pozicionet e drejta; • 5 pozicionet e lirshme të këmbëve; • 2 pozicionet e mbyllura të këmbëve; 7 pozicionet e duarve; - realizon teknikisht dhe artistikisht: • uljet e ngadalta; • uljet e shpejta; - realizon teknikisht dhe artistikisht: • në majën e gishtave me kalim në thembër; • në majën e gishtave me kalim në thembër në demi – plie; • me një rrahje të shputës në pozicionin V të hapur; • me dy rrahje të shputës në	28 orë

	- Zapateado. - Grand battements jetes me rënie në këmbën e punës. - Çelësi. - Por de bras në levë. - Rrëshqitja e këmbës në tokë .	pozicionin V të hapur; • me element të tarantelës; • me majë të gishtave të këmbës së punës me ndalim anash ose mbrapa; • me themër të këmbës së mbështetjes me ndalim para ose mbrapa; • me themër në shputën e këmbës së mbështetjes; • me portebra me dorë dhe kokë; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizje: • në të gjithë shputën dhe në releve; • me kthimin e gjurit nga pozicion i hapur në pozicion të mbyllur dhe nga pozicion i mbyllur në pozicion të hapur; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizje të ngadaltë dhe të shpejtë; - realizon ushtrimin me lëvizje të ndryshme te flick –flack; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • të koordinuara me pas glissade; • bolero; • hota; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • me rrahje; • me ulje në gjunjë; • me 1 këmbë; • me të dyja këmbët; • me të dyja këmbët me kthesë; • të karaktereve të ndryshme; • me këmbë të shtrira. • të mbledhura hungarez; - performon secilin ushtrim në karakterin e përcaktuar nga mësuesi; - realizon lëvizjet në karaktere të ndryshme botërore.	
Mesi i sallës	- Përsëritja e disa ushtrimeve të levës në mes të sallës.	- realizon: - battement tendus; - battement tendus jetes; - attement developpe; - flick – flack.	6 orë

Kërcime	- Lëvizje të kërcimit hungarez. - Lëvizje të kërcimit italian, Tarantela. - Lëvizje të kërcimit rus. - Lëvizje të kërcimit spanjoll.	- Realizon: - pozicionet e duarve dhe të këmbëve; - pas balance; - battement develope; - rrëshkitje e këmbës në tokë (gabriol); - retire - çelësin me një këmbë - çelësin me dy këmbë; - çelësi me rrotullim; - pozicionet e duarve dhe të këmbëve; - ëvizja e duarve me dajre; - rrëshkitjen e këmbës me majë përpara; - hedhjet e vogla të këmbës përpara; - pas jete; - pas jete me hapjen e këmbës tjetër në 45° ose në 90°; - pas balance; - pas echappe; - pozicionet e këmbëve dhe të duarve; - lëvizjet kryesore të duarve; - ecjen e rrjedhshme; - uljet e valleve ruse; - pozicionet e këmbëve dhe të duarve; - por de bras i duarve; - sapateado; - pas de basque; - realizon teknikisht dhe artistikisht etyde të krijuara me lëvizjet e mësuara; - kupton ndyshimet esenciale midis lëvizjeve të kërcimeve të vëndeve të ndryshme.	34 orë

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit

Në klasën X ndodh njohja e parë e nxënësve me disiplinën e këcimit botëror. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet vendosjes së trupit, këmbëve, duarve dhe kokës në ushtrimet që kryhen në levë dhe në mes të sallës. Më tej mund të realizohen koombinime të ushtrimeve të ndryshme me njëri-tjetrin, në karaktere të ndryshme muzikore dhe, gjithashtu, ushtrime të ndryshme për zhvillimin e koordinimit. Këtë vit realizohen etyde jo shumë të vështira me 3-4 lëvizje të mësuar në 8 - 16 masa muzikore.

Gjatë klasës X mësohen elementet kryesore të kërcimeve më të njohura skenike, si: tarantela, hungareze, ruse dhe spanjolle.

Rekomandime për përcaktimin e repertorit koreografik

- Ushtrime në levë - Ushtrime në mesin e sallës - Etyde hungareze - Etyde italiane	- Ushtrime në levë - Ushtrime në mesin e sallës - Etyde ruse - Etyde spanjolle	- Ushtrimet në levë - Ushtrime në mes të sallës - Etyde hungarez, italian, rus dhe spanjoll. - Në zgjedhje të pedagogut, një valle 16 – 32 masa muzikore

Rekomandime për vlerësimin e nxënësve

Niveli i lartë: Nxënësi merr vlerësimin maksimal, kur ka përvetësuar të gjitha lëvizjet e dhëna nga mësuesi dhe arrin të luajë teknikisht dhe me karakterin e duhur (artistikisht) etydet e ndërtuara, kërcimet e dhëna dhe materialet nga repertori skenik. .

Niveli mesatar: Nxënësi merr vlerësim mesatar, kur ka pëvetësuar materialin e dhënë, por nuk arrin të realizojë lëvizjet, etydet, kërcimet në teknikën e duhur ose në karakterin e uhur. Nxënësi mund të vlerësohet mesatar edhe kur arrin të realizojë teknikisht dhe rtistikisht lëvizjet por nuk arrin të krijojë marrëdhënien e duhur me partnerin dhe me kërcimtarët e tjerë.

Niveli i dobët: Nxënësi merr vlerësimin dobët, kur nuk përvetëson tërësisht programin e dhënë dhe kur lëvizjet e përvetësuara nuk kanë realizim teknik ose artistik.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Ushtrime të karakterit botëror**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të mësimit të lëndës "Ushtrime të karakterit botëror", nxënësi:

- njihet me përmbajtjen e lëndës;
- realizon lëvizjet në karaktere të ndryshme botërore, si p.sh., *battement tendu* në karakter rus, polak etj.;
- mëson kërcimet e karakterit popullor dhe akademik të popujve të ndryshëm;
- realizon *ushtrimet me lëvizje të ndryshme;*
- realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjet;
- performon secilin ushtrim në karakterin e përcaktuar nga mësuesi;
- edukohet me karakteret, stilet dhe mënyrat e kërcimeve të karakterit botëror;
- zhvillon teknikën e kërcimit, muzikalitetin dhe kërcyeshmërinë.

2. Përmbajtjet e tematike e lëndës "Ushtrimet e karakterit botëror"

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**
Ushtrimet në levë	- Ulje e plotë (grand – plie) nga pozicioni I i drejtë me kthimin e gjunjëve. - Rrëshqitja e këmbës në tokë (battemet tendus). - Hedhjet e vogla të këmbës (Battement tendus jetes). - Rond de jambe parter. - Battement fondu. - Pas tortille. - Kthesat. - Battement developpe me shtesë rrahjen e thembrës së këmbës së mbështetjes. - Flick- flack dyshe e kombinuar me tip -top dhe me kthesa. - Grand battements jetes me rënie në këmbën e punës. - Revoltad (hungarez). - Rastjashka mbrapa nga pozicioni I i drejtë. - Pas debourree.	**Nxënësi:** - ekzekuton teknikisht dhe artistikisht lëvizjen e mësuar**;** - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • me kthim në pozicion të mbyllur dhe hapjen e këmbës anash; • me kthim në pozicion të mbyllur dhe hapjen e këmbës anash në demi - plie • me rrahjen e thembrës së këmbës së mbështetjes; • e kombinuar me gjysmë kthesat; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • me një rrahje të thembrës së këmbës së mbështetjes; • me dy rrahje të thembrës së këmbës së punës në tokë dhe ngritja në gjysmë shputë të këmbës së mbështetjes (pas	26 orë

		pique) ; • battement tendus jetes balançoir në demi plie; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • me kthim të këmbës së mbështetjes në majë me ndalim anash ose mbrapa; • me kthim të këmbës së mbështetjes me thembër me ndalim anash ose mbrapa; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • battement fondu 45° me ngritje në gjysmë shputë të këmbës së mbështetjes dhe të koordinuar me lëvizje e dorës; • battement fondu në 90° në të gjithë shputën dhe në releve; • thyerja e trupit përpara dhe mbrapa me këmbës e punës në passe në pozicion të mbyllur; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • pas tortille dyshe; • me ngritjen në gjysmë shputë ë këmbës së mbështetjes; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • nga pozicioni V, i hapur e ngadaltë (soutenu en tournant); • në një këmbë *en dehors* dhe ën dedans; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • në ngritje në gjysmë shputë, e ngadaltë dhe e shpejtë; • me ulje në gjunjë; • të kombinuar me fuette; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • në karaktere të ndryshme; • dyshe;	

		• të kombinuar me tombe; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • në gjysmë rrethi me të gjithë shputën në tokë; • në gjysmë rrethi me ngritjen në gjysmë shputë të këmbës së mbështetjes; • me hedhje në ajër; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjen: • me ulje të plotë në këmbën e mbështetjes; • me ulje të plotë dhe thyerje të trupit mbrapa; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizje: • të karakterit polak; • të karakterit hungarez; • të karakterit rus; - realizon ushtrimet të ndërtuara me lëvizje të reja dhe të koombinuara me lëvizje të përvetësuara më parë; - performon secilin ushtrim në karakterin e përcaktuar nga mësuesi.	
Mesi i sallës	- Përsëritja e disa ushtrimeve të levës në mes të sallës.	- ekzekuton: - battement tendus; - battement tendus jetes; - battement developpe; - pas de bourree; - realizon ushtrimet në stilin përkaës të kërkuar; - realizon saktë teknikisht dhe artistikisht ushtrimet; - zhvillon muzikalitetin dhe plastikën.	4 orë
Kërcime	- Lëvizje të kërcimit hungarez. - Lëvizje të kërcimit italian, Tarantela. - Lëvizje të kërcimit polak, Mazurk**.** - Lëvizje të kërcimit spanjoll	- realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjet: - battement developpe të ndryshme; - çelësin me dy këmbë; - çelësin me dy këmbë me rrotullim;	32 orë

		- passe me ndërrim të pozicionit; - pas de bourree anash; - uljet në gjunjë nga hapi *gabriol* në 45°; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjet: - pas ballone; - pas de basque; - hedhjet e vogla në një këmbë në gjysmë ulje; - rrotullimet en dehors dhe en dedans; - realizon teknikisht dhe artistikisht: - pozicionet e këmbëve dhe të duave; - lëvizjet kryesore të duarve; - çelësin; - pas balance; - pas gala; - pas de bourre anash; - pas marche; - gabriol në tokë dhe në ajër; - realizon teknikisht dhe artistikisht: - hapat në gjysmë ulje me zgjatjen e këmbës përpara ose mbrapa; - hapat me një ose dy rrahje të shputës në tokë; - hedhjet e vogla në dy dhe një këmbë; - pas balance; - pas glisade; - pas glisade me ngritje në releve; - realizon teknikisht dhe artistikisht etyde të krijuara me lëvizjet e mësuara.	
Repertor	- Kërcim karakteri nga akti i dytë i baletit “ Arrëthyesi”.	- njeh karakterin dhe historinë e kërcimit; - mëson lëvizjet e kërcimit; - ekzekuton në mënyrë artistike dhe me muzikalitet kërcimin.	6 orë

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Në klasën XI mësohen lëvizje më të vështira në levë dhe në mesin e sallës, gjithashtu ndërtohen dhe etyde më të gjata dhe më të vështira që kanë për qëllim zhvillimin e koordinimit të lëvizjeve.
Sipas ecurisë së përvetësimit të ushtrimeve në levë rekomandohet që disa nga ato lëvizje të zhvillohen dhe në mesin e sallës duke i koordinuar me lëvizjet e duarve. Me lëvizjet e mësuara gjatë klasës X dhe me lëvizjet e reja të mësuara në klasën XI ndërtohen etyde me 32 masa muzikore.

Rekomandime për përcaktimin e repertorit koreografik		
- Ushtrime në levë - Ushtrime në mesin e sallës - Etyde hungareze - Etyde italiane - Etyde spanjolle	- Ushtrime në lev - Ushtrime në mesin e sallës - Etyde polake - Mësimi i një nga kërcimeve të karakterit, nga akti i dytë i baletit “Arrëthyesi”	- Ushtrimet në levë - Ushtrime në ,es të sallës - Etyde hungareze, italiane, ruse dhe spanjolle - Kërcim nga repertori skenik

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Ushtrime të karakterit botëror**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. **Rezultatet e të nxënit:**

Në përfundim të lëndës "Ushtrime të karakterit botëror", nxënësi:

- njihet me përmbajtjen e lëndës;
- mëson kërcimet e karakterit popullor dhe akademik të popujve të ndryshëm;
- realizon *ushtrimet me lëvizje të ndryshme;*
- realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjet;
- performon secilin ushtrim në karakterin e përcaktuar nga mësuesi;
- edukohet me karakteret, stilet dhe mënyrat e kërcimeve të karakterit botëror;
- zhvillon teknikën e kërcimit, muzikalitetin dhe kërcyeshmërinë.

2. **Përmbajtjet tematike e lëndës "Ushtrimet e karakterit botëror"**

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**

Ushtrimet në levë	- Përsëritja e ushtrimeve të levës, të mësuara në klasën X dhe XI, të koombinuara me daljen në mes të sallës.	**Nxënësi:**
		- realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjet të karaktereve të ndryshme dhe të lidhura me mesin e sallës:
		  - demi dhe grand plie;
		  - battament tendus;
		  - battement tendus jetes;
		  - rond de jambe parter;
		  - battement fondus;
		  - retire dhe pas tortille;
		  - adagio;
		  - grand battements.
		- realizon ushtrimet të ndërtuara me lëvizje të ndryshme skenike.
			8 orë

Kërcime	- Kërcim spanjoll.
	- Kërcim hungarez.
	- Kërcim polak.
	- Kërcim talian.
	- Kërcim rus.
		- ekzekuton:
		  - në mënyrë të saktë teknike dhe stilistike të gjitha lëvizjet e mësuara të kërcimeve të ndryshme;
		  - të gjitha kërcimet në çift, duke krijuar një marrëdhënie të qartë me partnerin;
		  - kërcimet duke kuptuar lëvizjet *dos a dos*, rrotullimet e ndryshme dhe hedhjet në ajër;
			40orë

		- kërcimet e karaktereve të ndryshme, të ndërlidhura me ushtrimet në levë.	

Repertor	- Pjesë nga baletet:
	- *"Liqeni i mjelmave";*
	- *" Rajmonda "*
		- realizon:
		  - kërcimin spanjoll;
		  - kërcimin e mazurkes;
		  - kërcimin Cardash;
		- realizon në mënyrë të saktë teknike, artistike dhe muzikore, kërcimet e repertorit.
			20 orë

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit

Në klasën XII fillon mësimi i vendosjeve të ndryshme që kanë partnerët në kërcim dhe mësohet marrëdhënia e partnerëve gjatë kërcimit. Gjithashtu, vështirësohen etydet e ndërtuara në bazë të lëvizjeve të valleve hungareze, polake, ruse, italiane dhe spanjolle, të ndërtuara 32 – 64 masa muzikore. Gjatë këtij viti përvetësohet teknika e hedhjeve dhe e rrotullimeve në çift.

Gjatë klasës XII ndryshon dhe struktura e mësimit. Pjesa më e madhe e mësimit zhvillohet në mesin e sallës. Në levë mësohen vetëm ato lëvizje që mund të paraqesin vështirësi në zhvillimin në mesin e sallës.

Rekomandime për përcaktimin e repertorit koreografik.		
- Ushtrime në levë - Etyde hungaeze - Etyde Italiane - Etyde Spanjolle - Etyd polak - Etyd rus	- Valle hungareze - Valle italiane - Valle spanjolle - Valle polake - Valle ruse	- Valle hungareze - Valle italiane - Valle spanjolle - Valle polake - Valle ruse - Kërcim nga repertori skenik
Mësimi i kërcimeve të karakterit nga baleti " Liqeni i Mjelmave " ose "Rajmonda", sipas përzgjedhjes së mësuesit		

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Në klasën X ndodh njohja e parë e nxënësve me disiplinën e kërcimit botëror. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet vendosjes së trupit, këmbëve, duarve dhe kokës në ushtrimet që kryhen në levë dhe në mes të sallës. Gjatë kësaj klase realizohen kombinime të ushtrimeve të ndryshme me njëri-tjetrin, në karaktere të ndryshme muzikore dhe, gjithashtu, ushtrime të ndryshme për zhvillimin e koordinimit. Gjithashtu, realizohen etyde jo shumë të vështira me 3-4 lëvizje të mësuara, në 8-16 masa muzikore. Gjatë vitit, në këtë klasë mësohen elementet kryesore të kërcimeve më të njohura skenike, si: tarantela, hungareze, ruse dhe spanjolle.

Në klasën XI mësohen lëvizje më të vështira në levë dhe në mesin e sallës. Gjithashtu, ndërtohen dhe etyde më të gjata dhe të vështira që kanë për qëllim zhvillimin e koordinimit të lëvizjeve.

Sipas ecurisë së përvetësimit të ushtrimeve në levë rekomandohet që disa nga ato lëvizje të zhvillohen dhe në mesin e sallës duke i koordinuar me lëvizjet e duarve.
Me lëvizjet e mësuara gjatë klasës X dhe me lëvizjet e reja, të mësuara në klasën XI, ndërtohen etyde në 32 masa muzikore.
Në klasën XII mësimi fillon me vendosjet e ndryshme që kanë partnerët në kërcim dhe me mësimin e marrëdhënieve të partnerëve gjatë kërcimit. Vështirësohen etydet e ndërtuara në bazë të lëvizjeve të valleve hungareze, polake, ruse, italiane dhe spanjolle të ndërtuara në 32- 64 masa muzikore. Gjithashtu, gjatë këtij viti përvetësohet teknika e hedhjeve dhe e rrotullimeve në çift.
Në klasën XII ndryshon dhe struktura e mësimit. Pjesa më e madhe e mësimit zhvillohet në mesin e sallës. Në levë mësohen vetëm ato lëvizje që mund të paraqesin vështirësi në zhvillimin në mesin e sallës.

4. **Vlerësimi**

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur interpreton jo korrekt:
- lëvizjet e ushtrimeve dhe renditjen e ushtrimeve;
- teknikisht dhe artistikisht;
- shkallën e shpejtësisë.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur interpreton mirë*:*
- klasën e ushtrimeve të karakterit;
- lëvizjet e renditura të ushtrimeve;
- karakterin e duhur teknikisht;
- kërcimet e dhëna;
- me pak gabime lëvizjet teknikisht dhe artistikisht;
- me nuanca dhe shoqërim muzikor.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:
- interpreton *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Duet klasik**
Klasa: **X**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Duet klasik", nxënësi:

- njeh përmbajtjen e lëndës;
- demonstron një interpretim të lartë dhe kulturë kërcimtarie;
- demonstron teknikë interpretimi të shembujve të padjerzhkave *par terre* dhe ajrore, muzikore, si dhe shprehi skenike;
- realizon dy duete të kërcimit klasik të trashëgimisë ose të repertorit bashkëkohor me ngarkesë të plotë;
- edukohet me ngarkesë skenike të përgjithshme;
- ushtrohet në ushtrimet kërcyese;
- kupton ndërtimin e ushtrimit brenda 16 takteve muzikore.
- krijon marrëdhënie të ndërsjellta gjatë kërcimit me partnerin.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Duet klasik"

Program i detyryeshëm	**Tema mësimore**	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**
Padjerzhkat me të dyja duart pas belit Padjerzhkat *par terre*	- *Relevé* nga pozicioni i pestë, i dytë dhe i katërt me dy dhe me një këmbë. - Lëvizjet ndihmëse dhe lidhëse në të gjithë pozat e vogla dhe të mëdha. - Pozat e mëdha dhe të vogla. - *Developpé* në 45^0 dhe 90^0 në të gjitha pozat e mëdha të kërcimit klasik. - *Developpé passé*, *grand rond de jambe* në të gjitha drejtimet dhe pozat. - *Grand port de bras*. (kombinacioni *temps lié* në 90^0 mund të jetë kryesor). - Kthesat jo të plota me dy dhe një këmbë (¼ dhe ½ e rrethit). - Kthesat jo të plota (në 1/2 dhe 1/2 e rrethit) dhe të plota me ndërrim të pozës fillestare të vajzës me anë të *passé*, *grand rond de jambe* etj. - *Grand fouetté en dehors dhe en dedans.* - *Grand fouette en tournant en dehors.* - *Tour lents* në pozat e vogla (1 rrotullim) - *Tour lents* në pozat e mëdha. (1 rrotullim).	***Nxënësi:*** - njihet-me programin që përmban lënda; - njihet dhe përvetëson mbajtjen e vajzës me dy duar mbas belit; - kupton dhe realizon vendosjen e vajzës në pikën e qëndresës; - realizon kalimin e peshës së trupit të vajzës nga një këmbë në tjetrën duke e mbajtur atë me dy duar mbas belit; - përvetëson dhe realizon aftësinë për të mbajtur vajzën në këmbën e mbështetjes, kthimin e saj në kthesa e ndryshme dhe kalimin e	**22 orë**

	- *Tour lents* me ndërrimin e pozës fillestare me anë të *passé, grand rond de jambe etj.* (1 rrotullim). - *Preparation* për *tours en dehors dhe en dedans enface dhe epoule,emt* . - *Preparaion* për *tours en dehors dhe en dedans en face dhe epoulment* me përfundim në pozë të vogël ose të madhe. - *Tours* nga pozicioni IV en dehors me përfundim në pozë të vogël ose të madhe. - *Tours* nga pozicioni V en dehors dhe en dedans me përfundim në pozë të vogël ose të madhe. - *Tours en dehors nga poza e vogël croisse* përpara me demi plie. - *Tours en dehors nga poza e vogël croisse* përpara pa demi plie. - *Padjerzhka* në pozë dhe vendosje " *në rënie ":* - në pozicionin fillestar; - me fyyrë nga partneri; - me shpinë nga partneri; - me shpinë në gjoksin e partnerit.	vajzës nga majat e gishtave në demi – plie; - realizon mbajtjen e vajzës në pozat e vogla dhe të mëdha duke qëndruar mbrapa saj, pranë saj dhe me fytyrë nga vajza. - përforcon llojet e ndryshme te *grand port de bras;* - zhvillon-*padjerzhkat* në rënie, *tour lents.*	
Padjerzhkat me të dyja duart pas belit *Hedhjet e vogla* dhe *ngritjet e vogla* deri në nivelin e gjoksit dhe supit	- Hedhjet e vogla të kërcimit klasik nga dy këmbë në dy këmbë në vend dhe me zhvendosje në të gjitha drejtimet. - Hedhjet e vogla nga dy këmbë në një këmbë, në vend dhe më zhvendosje në të gjitha drejtimet. - Hedhjet e vogla me ndërrim këmbë në vend dhe me zhvendosje në të gjitha drejtimet. - Hedhjet e vogla në të njëjtën këmbë në vend dhe me zhvendosje në të gjitha drejtimet. - Hedhjet e mesme të kërcimit klasik si: Sissone ferme, sissone ouverte, ballowe etj., në vend. - Hedhjet e mesme me zhvendosje në të gjitha drejtimet. - Hedhjet e mëdha të kërcimit klasik në vend dhe me zhvendosje. - Ngritje e vogël nga *poza* "	- kupton dhe zhvillon ndjesinë e tempit të përbashkët me vajzën gjatë hedhjeve; - kupton dhe realizon ngritjen e vajzës dhe uljen e saj butë në tokë duke e ndihmuar vajzën të hidhet më lart; - kupton dhe realizon ndryshimin e pozave në uljen nga hedhja; - përvetëson teknikën e mbajtjes së vajzës gjatë hedhjes. Vajza realizon hedhjet në pozat e kërkuara; - përvetëson teknikën e ngritjes dhe të mbajtjes së vajzës në ngritjet e vogla, në nivel të	**14 orë**

	rënie" në poziocion horizontal në duart e djalit. - Ngritje e vogël në *pozën arabesque I* deri te gjoksi I djalit. - Ngritje e vogël në *pozën " Llastoçka"* në tazin e djalit. - Ngritje e vogël në *pozën arabesque I* në kofshën e djalit. - Ngritje e vogël në *pozën "Ribka"* në duart e djalit. - Ngritje në pozën *" Stol"* në supin e djalit. - Ngritje në pozën *"Ribka"* në supin e djalit.	gjoksit dhe të supit; - realizon pozat e kërkuara në të gjitha ngritjet e vogla.	
Kombinacione me padjerzhkat me të dyja duart pas belit	- Kombinacion *në temp adagio* me padjerzhkat par terre. - Kombinacion *në temp adagio* e ndërtuar me padjerzhkat e v - ogla.Kombinacion *në temp andante* e ndërtuar me tourat e ndryshme. - Kombinacion *në temp allegro,* e ndërtuar me hedhjet e vogla. - Kombinacion *në temp allegro,* e ndërtuar me hedhjet e mesme. - Kombinacion *në temp allegro,* e ndërtuar me hedhjet e mëdha.	- përforcon teknikën e mbajtjes së vajzës në padjezhkat par terre me të dyja duart mbas belit me anë të kombinacioneve; - përforcon teknikën e mbajtjes së vajzës në hedhjet dhe ngritjet e vogla; - realizon saktë teknikisht pozat dhe lëvizjet e kërkuara.	**6 orë**
Padjerzhka me dy duar pas dy duarve të vajzës (pas kisteve ose kyçeve) Padjerzhkat *par terre*	- Pozat e vogla dhe të mëdha. - Lëvizjet lidhëse dhe ndihmëse. - Developpe, passé dhe grand rond de jambe. - Kthesa bazë në 360°. - Grand fouette en tornant en dehors. - *Tour lents* në pozën *attitude*: - Vajza mbahet me të dyja duart pas një dore të djalit (pas kistit dhe supit). - Djali mban vajzën në kist ose kyçe në të dyja duart. - *Tour lent* në pozën *a la seconde* në 90°. - *Tour en dedans* nga poza *attitude* (para tour vajza mbahet me dy duart te dora e djalit). - *Tour* nga poza *a la seconde në 90°* me	- njihet dhe përvetëson mbajtjen e vajzës nga kistet e duarve; - njihet dhe përvetëson mbajtjen e vajzës nga parakrahu; - njihet dhe përvetëson mbaajtje e kombinuar me një dorë nga kisti dhe dorën tjeër nga beli; - realizon mbajtjen e vajzës në pozat e vogla dhe të mëdha dhe në të gjitha lëvizjet e mësuara me mbajtje me dy duar, mbas duarve të	**8 orë**

	mbajtjen nga kistet. - *Tour en dehor* nga poza *croisee* përpara. (me mbajtje nga beli dhe nga gishti i djalit). - *Padjerzhka* në pozë dhe vendosje *"në rënie":* - në pozicionin fillestar me mbajtje: - me një dorë në mes dhe dorën tjetër te parakrahu; - në pozën arabesque I me mbajtje nga paakrahët; - në pozën arabesque I me mbajtje nga kistet.	saj, duke qëndruar mbrapa saj, pranë saj dhe me fytyrë nga vajza; - zhvillon padjerzhkat në rënie, tours e ndryshme dhe tours lents.	
***Padjerzhka* me dy duar, pas dy duarve të vajzës** *Hedhjet* dhe *ngritjet e vogla* deri në nivelin e gjoksit dhe supit	Hedhjet e kërcimit klasik. - *Grand assemble* me mbajtje me një dorë nga kisti dhe dora tjetër në bel. - Ngritja e vogël nga poza *attitude efface* në pozicionin horizontal. - Ngritja në pozën *"stol"* në sup e mbajtur nga dy duart.	- zhvillon tempin e përbashkët të hedhjes gjatë mbajtjes së vajzës me dy duar mbas duarve të saj; - përvetëson teknikën e uljes së butë të vajzës në tokë; - përvetëson teknikën e ngritjes së vajzës në ngritjet e vogla duke e mbajtur atë nga duart.	**8 orë**
Kombinacione me padjerzhkat me të dyja duart pas belit, me dy duar pas dy duarve të vajzës dhe të kombinuara.	- Kombinacion *në temp adagio* me padjerzhkat me të dyja duart pas belit. - Kombinacion *në temp adagio* me padjerzhkë me të dyja duart pas dy duarve të vajzës. - Kombinacion *në temp adagio* me pardjezhkë me duar të kombinuara. - Kombinacion *në temp andante* e ndërtuar me tourat e ndryshme dhe me pardjeshka të duarve të kombinuara. - Kombinacion *në temp andante* e ndërtuar me hedhjet, ngritje dhe kombinim duarsh. - Kombinacion *në temp allegro* e ndërtuar me hedhjet me padjerzhkë me dy duar mbas belit të vajzës.	- realizon mbajtjen e vajzës në të tria format; - përforcon njohuritë nëpërmjet praktikimit të lëvizjeve në kombinacione të tempeve të ndryshme; - kupton dhe realizon marëdhënien e partnerëve gjatë realizimit të kombinacioneve; - zhvillon muzikalitetin dhe teknikën skenike.	**10 orë**

	- Kombinacion *në temp allegro* e ndërtuar me hedhjet me pardjeshkë me dy duar mbas duarve të vajzës. - Kombinacion *në temp allegro* e ndërtuar me hedhje me padjerzhkë, me duar të kombinuara.		

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Duet klasik**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

3. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Duet klasik", nxënësi:

- njeh përmbajtjen e lëndës;
- demonstron një interpretim të lartë dhe kulturë kërcimtarie;
- demonstron teknikë interpretimi të shembujve të padjerzhkave *par terre* dhe ajrore, muzikore, si dhe shprehi skenike;
- realizon dy duete të kërcimit klasik të trashëgimisë ose të repertorit bashkëkohor me ngarkesë të plotë;
- edukohet me ngarkesë skenike të përgjithshme;
- ushtrohet në ushtrimet kërcyese;
- kupton ndërtimin e ushtrimit brenda 16 takteve muzikore;
- krijon marrëdhënie të ndërsjellta gjatë kërcimit me partnerin.

Kjo lëndë zhvillohet në dy grupe.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Duet klasik"

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezulatet e pritshme**	**Orët**
***Padjerzhka* me të dyja duart e djalit pas dy duarve të vajzës**	- Të gjitha llojet *grand fouetté en tournant en dehors* dhe *en dedans*, me kalim dhe pa kalim, me majë të gishtave në *demi-plié*. - *Tour lents* – "*abvodka*" nëpër 2-3 dhe në shumë rrotullime, në kohën në të cilën vajza ndërron disa herë pozat, por pastaj kalohet në *tour en dehors* dhe *en dedans.* - *Tour*at (nëpër 2-3 dhe shumë rrotullime): - *Tour*at nga të gjitha pozat e mëdha të kërcimit klasik, me përfundim në po atë pozë (mësohet *en dehors* dhe *en dedans*, me kalim dhe pa kalim në *demi-plié*). - *Tour*at me hapa *tombeé*, me *preparation degage*. - *Tour*at në gjendje *à la seconde* në 90^0 dhe në pozë *attitude*. Forca te	**Nxënësi:** - njihet me *Padjezhkat* me të dyja duart pas belit; - përvetëson *Tourat* nga të gjitha mënyrat dhe pozat.	6 orë

	këto *tour*-a (u referohet pikave "b" dhe "c"), vajza vrapon te djali, i cili e kap atë në kohën e rrotullimeve dhe të dy qëndrojnë në pozën që duan.		
***Padjerzhka* me të dyja duart e djalit pas dy duarve të vajzës** (pas kistit ose kyçit).	- *Tour*at nga gjendjet e ndryshme dhe pozë, vajza merr forcë te djali ose vrapon, shtyhet nga dora e tij, pastaj djali në fillim çon dorën e tij në belin e saj: - nga gjendja *à la seconde* në 90^0 (partnerët qëndrojnë me fytyrë përballë njëri-tjetrit); - nga poza *croisée* "prej poshtë dorës së partnerit" (në pozicionin fillestar vajza qëndron në këmbën e majtë, dora e djathtë në pozicionin e tretë, dora e majtë në pozicionin e dytë, djali pas saj); - nga pozat *attitude effacée* (djali qëndron para vajzës).	- njihet me mënyrën e mbajtjes së kistit të dorës nga kavalieri.	2 orë
Padjerzhkat me një dorë	- Ekzekutimi i vajzës *developpé*, *developpé passé*, *grand rond de jambe*, po ashtu, dallimi i kalimit nga njëra pozë tek tjetra, me lëvizjet ndihmëse dhe lidhëse. - Tërhiqet fort dora nga poza "qëndrim" në tokë në pozat *attitude* dhe *arabesque I*. - Partnerët rrotullohen ngadalë, pas kistit, ndryshojnë pozicionin e duarve, po ashtu, ndryshon dhe vetë gjendja e kistit. - *Tour lents* në të gjitha pozat e mëdha të kërcimit klasik pas kistit, pas kyçit. - *Tour*at pas kyçit nga poza *arabesque I*: - në gjendjen fillestare para *tour*ave djali e mban vajzën pas kyçeve të të dyja duarve, qëndron pas saj; - në gjendjen fillestare djali e mban vajzën pas kyçit të njërës dorë dhe qëndron me fytyrë nga ajo; - *Tour*at në kohën kur vajza mbahet me njërën dorë pas gishtit të djalit: - nga pozat *croisée* (vajza me forcë përpara, dora tjetër e saj mbahet pas	- njihet me *padjerzhkat* me një dorë; - zhvillon *Tours* në pozat *attitude, a la second.*	10 orë

	dorës së djalit); - në pozën *attitude* (këmba në 45^0) me hap, me *tombé*. - *Padjerzhka* me kistin e njërës dorë dhe tjetra te beli: - *n*ë ekzekutimin e vajzës *developpé, grand rond de jambe, developpé passé*. - *Grand port de bras* nga poza *arabesque I- III-IV, attitude effacée* dhe *croisée*. - *Tour lents* në të gjitha pozat e mëdha të kërcimit klasik. - *Padjerzhkat* e partnerëve në gjendjen "rënie" dhe poza (pas kistit, kyçit, belit, po ashtu, me mbështetje në trupin e djalit). Mësohet në të gjitha pozat e mëdha të kërcimit klasik.		
Padjerzhkat ajrore	- Në të gjitha hedhjet e kërcimit klasik mësohen *padjerzhkat* me të dyja duart pas belit, në lartësinë e duarve të djalit të ngritura lart. Po këto hedhje mësohen në *padjerzhkat* me të dyja duart pas belit të vajzës, si dhe me njërën dorë pas belit të saj. - *Tour* ajror nga pozicioni i pestë, me përfundim në pozicionin e pestë në *demi-plié* me *padjerzhkë* me të dyja duart pas belit. - *Grand jeté en tournant* në pozën *attitude* (me *padjerzhkë* me të dyja duart pas belit). - Hedhjet me fluturim rreth djalit me *padjerzhkë* me të dyja duart pas duarve: *assemblé en tournant, jeté entrelacé.*	- njihet me *padjerzhkat* në ajër; - përforcon njohuritë nëpërmjet praktikimit të pozave në ajër.	6 orë
Hedhjet në dorën e djalit, me përfundim në pozën "*ribka*"	- *Tour* ajrore nga pozicioni i pestë, me përfundim në pozicionin e pestë në *demi-plié* me *padjerzhkë* me të dyja duart pas belit. - *Grand jeté en tournant* në pozën *attitude* (me *padjerzhkë* me të dyja duart pas belit). - Hedhjet me fluturim rreth djalit me *padjerzhkë* me të dyja duart pas	- zhvillon *grand jetes en tournant në attitude.*	6 orë

	duarve: *assemblé en tournant, jeté entrelacé.*		
Hedhje deri në nivelin e kraharorit dhe të supit të djalit	- *Grand jeté* në pozën *attitude effacée* me *padjerzhkë* në të njëjtën dorë, me vendosjen e dorës pas belit të partneres. Kapja e vajzës në fluturim, djali duhet të bëjë rrotullim rreth vetes, në çfarëdo drejtimi. - Rrotullimet e vajzës në dorën e djalit, me hedhje në ajër, nga pozat "*ribka*" në gjendjen shpinë nga dyshemeja dhe e kundërta. - *Grand jeté* në pozën *arabesque I* për realizimin e hedhjes në kofshën e djalit, me qëndrim (me *padjerzhkë* me të dyja duart pas belit të vajzës).	- njeh dhe përforcon pozën *ribka.*	6 orë
Ngritjet e vajzës me fiksim poze në kraharor ose në supin e djalit	- Me *pas sauté*, *pas assemblé* të vogël, me figurën "qëndrim" "ribka" në një dorë, nga poza "qëndrim" në tokë, në supin e djalit, me kthesë në ajër, në pozën "llastoçka". - Me hedhje të mëdha: *jéte entrelace* në pozën "llastoçka", *saut de basque*, me realizim në pozicionin "qëndrim" me *pas sissonne*, me realizimin në pozicionin "qëndrim", kur këmbët janë në pozicionin e parë drejt, gjuri i thyer jepet pas shpinës së djalit: me hedhje (nga shpina e djalit), mbi supin, në pozën "llastoçka". - Ngritje në pozën *arabesque I* (deri në nivelin e kraharorit të djalit), me mbajtjen e vajzës në njërën dorë, me përkuljen e trupit, dora tjetër pas kofshës së këmbës së ngritur. - Kombinacioni në *temp adagio* (32 takte muzikore) realizohet vetëm me *padjerzhkat par terre*, në lloje të ndryshme - Kombinacioni, në *temp andante* (32 takte muzikore), realizohet në padjerzhkat *par terre*	- njeh pozat *arabesque* në ajër; - zhvillon *adagio* me kombinacione duke përdorur *padjerzhka par terre.*	18 orë

	dhe ajrore, në lloje të ndryshme. - Kombinacioni, në *temp andantino*, realizohet me *tour*a të ndryshme. - Kombinacioni në *temp allegro*, realizohet me ndryshime dhe me hedhje të vogla të kërcimit klasik, me hedhjet mbi duart te djali, me padjerzhkë pas belit të vajzës, me të dyja duart, me një dorë dhe me shembujt e kombinuar. - Kombinacioni në *temp allegro*, realizohet me ndryshimet e hedhjeve të mesme të kërcimit klasik, e hedhjeve mbi dy duart e djalit te beli i vajzës, me një dorë dhe me shembuj kombinimesh. - Kombinacioni në *temp allegro* realizohet nga hedhjet e mëdha të kërcimit klasik, me ngritjet e ndryshme, me hedhjet e saj nga njëra dorë e djalit. - Kombinacioni i shtatë - fragmente nga duetet klasike të trashëgimisë ose etydet dhe kompozimet.		

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Duet klasik**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Duet klasik", nxënësi:

- ekzekuton njohuritë dhe ngarkesën bazë në fushën e teknikës së *padjerzhkave*, të marra gjatë dy viteve të mëparshme shkollore;
- demonstron një interpretim të lartë dhe kulturë kërcimtarie;
- fiton lirshmërinë dhe zhdërvjelltësinë në ekzekutimin e rrotullimeve të ndryshme dhe *abvodka*-ve, në *adagio* dhe *allegro;*
- rrit cilësinë dhe nivelin e *tour*ave në disa duete.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Duet klasik"

Programi i detyrueshëm	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët

***Padjerzhkat* ajrore** **Hedhjet e mëdha dhe ngritjet me fiksim poze me të dyja duart e djalit të shtrira lart.**	- Hedhja (fluturimthi) me rrotullim në ajër nga poza "*ribka*" me realizimin e pozës "*llastoçka*" mbi sup. - *Tour*-ë ajrore nga pozicioni i pestë, me vendosjen në supin e djalit në pozicionin "ulur" (me *padjerzhkë* pas belit me të dyja duart). - *Grand jeté* me *padjerzhkë* me të dyja duart të fiksuara, poza fluturuese mbi supin e djalit (hedhje mbi shpinën e tij).	**Nxënësi:** - njeh programin që përmban lënda.	6 orë
Hedhjet e mëdha dhe ngritjet me fiksim poze me të dyja duart e djalit të ngritura lart.	- Me vendosjen e duarve paksa mbi belin e vajzës (me *pas sauté* e ose *pas assemblé* të vogël). - Në pozat *arabesque I, IV* (në *demi-plié* në këmbën mbështetëse). - Në pozën *arabesque III* (me vrull dhe *pas sissonne tombé*). - *Grand jeté* në pozën *arabesque I*, me padjerzhkën me duar pas belit dhe pastaj me kalim të dorës nën kofshën e vajzës. - *Grand jeté* në pozën *attitude effacée* me padjerzhkë me të dyja duart pas belit, pastaj me kalimin e njërës dorë nën kofshën e vajzës. - *Grand fouetté sauté*, me mbarimin në pozën *arabesque IV*. - *Saut de basque*, me mbarimin në pozicionin "ulur". - Poza "*llastoçka*" me vrull dhe *pas sissonne tombé.* - Me mbështetjen në mes dhe nën gjurin e këmbës së shtrirë, me fiksim poze horizontal, me shpinë nga dyshemeja. - Disa elemente të *padjerzhkave* të ndërlikuara, të cilat mësohen sipas dëshirës së pedagogut, në varësi nga mundësitë profesionale të nxënësve (fakultative).	- Përforcon teknikën e *padjerzhkave* të mësuara në vitet e mëparshme.	18 orë
Hedhjet e mëdha dhe ngritjet me fiksim poze me të dyja duart e	- Me mbështetjen në mesin e vajzës dhe nën gjurin e këmbës së shtrirë të saj (trupi i vajzës thyhet mbrapa). - Me mbështetjen te muskujt e vitheve dhe mbi gjurin e këmbës së shtrirë (në		8 orë

djalit të ngritura lart.	pozicionin "ulur"). - *Grand jeté* në pozën *arabesque I*, me *padjerzhkë* me të dyja duart pas belit, pastaj me kalim në njërën dorë në trupin e përkulur dhe në pozën *attitude effacée*, me *padjerzhkë* me të dyja duart pas belit, pastaj me kalim me një dorë në mesin e vajzës. - *Saut de basque* me përfundimin në pozicionin "ulur".		
Hedhje e vajzës nga njëra dorë dhe me të dyja duart dhe fiksim poze lart, me përfundim në pozën "ribka".	- Nga poza *arabesque I-II-IV*. - Nga poza "*llastoçka*". - Nga pozicioni "ulur" në një ngritje të duarve lart.		8 orë
Hedhje e vajzës me rrotullime të dyfishta në ajër në pozicionin horizontal, me përfundim në pozën "ribka".	- Kombinacioni në *temp adagio*, realizohet *padjerzhka par terre* me të gjitha mënyrat. Ekzekutohet fillimisht nga 2-3 çiftet e para dhe më pas me të tjerët, nga i pari tek i fundit. - Kombinacioni në *temp adagio* - padjerzhkë ajrore. - Ekzekutojnë 2-3 çifte me aftësi e mundësi fizike individuale më të mira. Kombinacioni në *temp adagio* - është pjesë dueti ose etyd. - Ekzekuton një çift dhe nuk është e domosdoshme të ekzekutohet nga e gjithë klasa. - Kombinacioni i katërt - pjesa e dytë nga dueti ose etydi. - Kombinacioni në *temp allegro*, realizohet në pamje të ndryshme *tour*ash. - Ekzekutohet nga 2-3 çifte, është e rëndësishme për të gjithë klasën. Kombinacioni në *temp allegro*, realizohet në lloje të ndryshme të hedhjeve të vogla të kërcimit klasik, me *padjerzhkë* pas belit dhe me të dyja duart. - Ekzekutojnë 2-3 çifte, e rëndësishme	- zhvillon lirshmërinë në ekzekutimin e rrotullimeve të ndryshme; - përforcon *abvodka, adagio, dhe allegro.*	28 orë

	për të gjithë klasën. - Kombinacioni në *temp allegro*, realizohet me hedhje të mesme dhe të mëdha të kërcimit klasik, hedhje te partneri, në dorë dhe në sup. . Kombinacioni në *temp allegro*, përmbyllet me *padjerzhkat* më të ndërlikuara të mësipërme. - Ekzekuton vetëm një çift me aftësi e mundësi të mira individuale dhe nuk është e domosdoshme të ekzekutohet nga e gjithë klasa.		

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Në klasën X të gjitha kombinacionet mësohen në përputhje të plotë me programin e dhënë gjatë një viti shkollor për duetin klasik. Elementet teknike të kërcimit duet dhe kombinacionet duhet të jenë të vendosura në logjikën e radhës, të ekzekutohen pa u nxituar së tepërmi, me qëllim që çdo shembull *padjerzhkë* të kuptohet qartë.
Përveç njohjeve dhe ekzekutimit të shembujve teknikë të *padjerzhkave*, partnerët, në çdo pjesë, duhet të dinë momentin se ku ndodhen, pozicionin e vet, që nga pozat organike në kombinim me pozat e partnerëve, me shprehi estetike e skulpturale. Të gjitha kombinacionet ekzekutohen me njërën dhe me tjetrën këmbë, gjithashtu, në anën e djathtë dhe në anën e majtë. Provimi duhet të bëhet në shoqërimin muzikor dhe me piano; në mbyllje nxënësi përshëndet dhe largohet nga salla.
Për realizimin e këtij programi, mësuesi mbështetet në librin e botuar në shqip nga Shpëtim Dajçi me titull ”Mjeshtëri e duetit klasik”.
***Shënim*.** Në klasën XI ekzekuton një çift dhe nuk është e domosdoshme për të gjithë klasën.

Rekomandim për repertorin koreografik:

- Dueti i Lizës me Kolenin, nga aktet I dhe II të “Kujdesi i kotë”, i P.Hertelit, me koreografi të Xh. Doberval, L. Ivanov, M. Petipa.
- “*Pas de trois*” nga “Kukulla Feja” i R. Drigo, koreograf S. dhe N. Legat.
- “*Pas de deux*” nga akti I “Zhizel”, të A. Adam, me koreografi të Zh. Korrall, Zh. Perro, M. Petipa.
- Valsi i Maries me Vacllavin nga akti I “Shatërvani i Bahçisarajit”, të B. Asafjev, me koreografi të R. Zaharov.
- Dueti nga akti II i “Fadeta”, i L. Delib, me koreografi të L. Llavrovski.
- *Minueti* (i Zhulietës dhe Parisit) nga akti I “Romeo dhe Zhulieta”, i S. Prokofiev, me koreografi të L. Llavrovski.
- *Adagio* nga “*pas de trois*”, tabloja I, akti I “Liqeni i Mjelmave”, i P. Çajkovskit, me koreografi të M. Petipa dhe L. Ivanov.

4. **Vlerësimi**

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur interpreton në mënyrë jo korrekte:

- lëvizjet e ushtrimeve;
- renditjen e ushtrimeve;
- realizimin teknikisht dhe artistikisht;
- shkallën e shpejtësisë së ngadaltë të ekzekutimit.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur interpreton mirë:

- ritmikisht lëvizjet e renditura të ushtrimeve,
- teknikisht dhe me karakterin e duhur,
- padjezhkat e dhëna,
- me teknikë të mirë individuale e me nuanca dhe shoqërim muzikor.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- interpreton *shumë mirë* të gjitha elementet e lartpërmendura.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Kërcim modern-konteporan (balet modern)**
Klasa: **X**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "**Kërcim kontemporan**", nxënësi:

- merr bazat e kërcimit kontemporan;
- shfaq aftësi teknike të lëvizjeve në hapësirë dhe kohë;
- përvetëson, *contraction – release;*
- koordinon lëvizjet trupore me frymëmarrjen dhe ritmet muzikore të ndryshme;
- thellon aftësinë e punës në grup nëpërmjet një disipline të re artistike, bazuar në ritme muzikore kontemporane.

5. Përmbajtja e temave te lëndës "Kërcim kontemporan"

Programi detyrueshëm	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Ushtrime të mesit të sallës	- Njohuri mbi lëndën e baletit kontemporan. - Punimi i muskulaturës: *Contraction*, *Uncontraction*. - Lëvizje *contraction – release*, *Roll Down* - *Roll Down* shoqëruar me lëvizjet e krahëve. - *Roll Down* me plie dhe këmbë në pozicionin I, II. - Lëvizje e trupit së bashku me kokën dhe muzikën. - *Flat Back I, II*. - *Flat Back II*. - *Flat Back me krahët para anash*. - *Flat Back III*. - *Foot work* - *Foot work Releve*. - *Foot work Atitude*. - *Foot work para, anash, mbrapa*. - Elementary balance *(lëvizjet e këmbëve).* - *Variacion (Elementary Balance)*. - *Fortification krahët dhe këmbët*. - *Fortification #1*. - Variacione në diagonal. - Imagjinatë.	**Nxënësi:** - njeh elementet bazë të kontemporanes; - zhvillon dhe kupton contraction-release; - përvetëson kordinimet trupore.	58 orë
Lëvizje në tokë	- *Elementary Balance* (muskujt e barkut). - Rrotullime në tokë.	- njihet me ushtrimet e tokës; - zhvillon frymëmarjen.	4 orë

Hedhje	- Hedhje të vogla në diagonal .	- njihet dhe zhvillon lëvizjen në hapësirë dhe në kohë.	2 orë
Varacione	- Variacion kontemporan.	- zhvillon dhe përvetëson kordinimin trupor me koordinimin muzikor.	4 orë

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Kërcim modern-konteporan (balet modern)**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Kërcim kontemporan", nxënësi:

- thellon njohuritë mbi zhvillimin e sistemit të kërcimit kontemporan;
- zhvillon më tej aftësinë teknike të lëvizjeve trupore në hapësirë, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht;
- kupton akumulimin e energjisë së brendshme;
- kupton dinamikën frymëmarrje-lëvizje;
- kupton kalimin e peshës së trupit nga njëra këmbë në tjetrën gjatë procesit kontemporan;
- mëson se masa e rritjes së aksenteve kërcyes nuk të çon në rritjen e masave muzikore;
- kupton kombinimin e ndërsjelltë të muzikës dhe të kërcimit duke rritur aftësitë interpretuese;
- thellon aftësinë e punës në grup nëpërmjet një teknike te re, bazuar në ritme të reja kontemporane.

2. Përmbajtja e temave te lëndës "Kërcim kontemporan"

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**
Ushtrime të mesit të sallës	- Përgatija e muskulaturës *Laterals. Laterals* (krahët, plie, koka). - *Laterals* variacion. - Lëvizje *contraction – release*. - *Release swings.* - *Release swings* (me palosje para - anash). - *Release swings variacion.* - *Fortification #2*. - *Fortification* pa shoqërim muzikor. - Shoqërimi i lëvizjeve me ritme të shpejtuara. - *Fortification #3*. - *Fortification* (lëvizje në diagonal). - Variacioni tokë – ajër. - Punimi i këmbës në tokë para - anash – mbrapa. - *Rond* në tokë para - anash – mbrapa. - Punimi i muskulaturës. - *Isolations* (qafa, koka). - *Isolations* (Pjesa e sipërme). - *Isolations* total .	**Nxënësi:** - njeh teknikën e lëvizjeve të reja; - zhvillon frymëmarjen, nëpërmjet akumulimit të energjisë së brendshme; - përvetëson hapësirën, duke zhvilluar dinamikën e lëvizjes.	46 orë
Lëvizjet në tokë	- *Fortification* (variacion në tokë) - Rrotullime në tokë (2 herë). - *Coccyx Balance.*	- njeh teknikën dhe zhvillon kontaktin me tokën;	6 orë

		- përvetëson dhe bashkërendon teknikën me frymëmarjen.	
Hedhjet	- Hedhje të kombinuara në diagonal.	- njehme kombinacionet e lëvizjeve; - zhvillon dinamikën e lëvizjeve; - përvetëson dhe rrit ndjeshmërinë muzikore.	4 orë
Variacionet	- Variacion (imagjinatë gjestikulacion). - Variacione në diagonal. - Variacione krijuese.	- aftësohet duke punuar me kombinacione të ndryshme artistike (koreografike dhe muzikore).	8 orë

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Kërcim modern-konteporan (balet modern)**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Kërcim kontemporan", nxënësi:

- zhvillon më tej aftësinë teknike të lëvizjeve trupore në hapësirë dhe kohë, horizontalisht ashtu edhe vertikalisht;
- thellon njohuritë mbi zhvillimin e sistemit të kërcimit kontemporan;
- zotëron energji të brendshme;
- trupëzon lëvizjen, emocionin dhe muzikën në kërcim;
- përvetëson dhe interpreton pjesë dhe variacione kontemporane;
- kupton ritmet e kombinuara muzikore;
- thellon aftësinë e punës në grup.

2. Përmbajtja e temave te lëndës "Kërcim kontemporan"

Programi i detyrueshëm	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Ushtrimet e mesit të sallës	- Përgatitja e muskulaturës. - *Paralel leg swings.* - *Deep lunges.* - *Pirouettes* ne pozicionin IV plie. - Variacion imagjinate. *Torso language.* - *Ricreation*. - *Torso language* (imagjinatë). - Punimi i këmbës në tokë para - anash – mbrapa. - *Rond* në tokë para - anash - mbrapa. - Punimi i muskulaturës. - Variacion krijues . - *Primitive sonat.*	***Nxënësi:*** - njihet me lëvizjet e reja; - zhvillon koncepte më të avancuara të teknikës kontemporane; - përvetëson ritmet dhe dinamikën e lëvizjeve në kohë dhe në hapësirë.	34 orë
Lëvizjet në tokë	- Rrotullimet të ndryshme me figuracione. - *Fortification*. - *Fortification* (muskujt e barkut dhe të shpinës)	- zhvillon forcën muskulare.	6 orë
Hedhjet	- Variacion hedhje diagonal - *Fortification* (ajër). - Variacion hedhje (tokë-ajër). - Variacion (hedhje të mëdha).	- aftësohet nëpërmjet kordinimeve të ndryshme tokë-ajër.	10 orë

Variacionet	- Variacion diagonal. - Variacion (imagjinatë gjestikulacion). - Variacion koreografik. - Variacion koreografik	- përvetëson dhe zhvillon imagjinatën; - rrit ndjeshmërinë muzikore nëpërmjet lëvizjeve kontemporane.	14 orë

3. **Udhëzime për zbatimin e programit**

Nëpërmjet këtij programi, nxënësi drejtohet drejt një disipline të re, të pavarur nga baleti klasik, dhe njëkohësisht disiplinë ndihmëse kryesore e teknikës klasike. Baleti kontemporan u jep nxënësve nëpërmjet teknikave të tij një lëvizje të gjerë emocionalisht dhe teknikisht. Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat me të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko-emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Kjo lëndë zhvillohet në grupe vajza dhe djem me shoqërim muzikor në CD.

Për realizimin e këtij programi, mësuesi mbështetet në teknikat bashkëkohore të kërcimit. Ushtrimet ose lëvizjet duhet t'i përgjigjen programit tematik. Ora e mësimit duhet ketë kërkesat bazë, si:

- përpikmëria në orar;
- përpikmëria në uniformë;
- organizim mbi bazën e logjikës muzikore e teknike;
- renditje dhe organizim sipas një koreografie;
- interpretim me ndjenjë.

Këto përbëjnë elementet kryesore të suksesit.

4. Vlerësimi

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- dallon *shumë mirë* pikat kryesore të baletit kontemporan dhe arrin t'i ekzekutojë ato me përpikëri dhe nivel të lartë teknik;
- përcakton *saktë: kohën, hapësirën, dinamikën, forcën dhe ritmin, duke i lidhur ato në bazë të filozofisë së lëvizjes;*
- shpjegon *qartë dhe natyrshëm* historinë e lindjes dhe zhvillimit të baletit kontemporan*;*
- shpreh *qartë dhe natyrshëm* shijet artistike nëpërmjet improvizimeve individuale, energjisë së brendshme dhe interpretimit;
- vlerëson duke mbajtur një qëndrim *të drejtë* ndaj punës në grup dhe ndërveprimit lëvizje-muzikë.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- dallon *mirë dhe arrin* të ekzekutojë saktë pikat kryesore të baletit kontemporan;
- përcakton funksionin e baletit kontemporan në formimin profesional, teknikën bazë dhe historikun e zhvillimit të kësaj disipline;
- shpjegon ndërlidhjen midis frymëmarrjes dhe lëvizjes, hapësirën trupore dhe ekuilibrin e brendshëm në kërcim;
- shpreh shijet artistike nëpërmjet aftësive të improvizimit;
- vlerëson duke mbajtur një qëndrim ndaj veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- arrin me vështirësi të përvetësojë teknikën bazë të baletit kontemporan dhe, si rrjedhojë, nuk jep rezultat të lartë profesional;
- arrin të zbatojë me vështirësi ndërveprimin muzikë-lëvizje;
- përshkruan me ndihmën e mësuesit aftësitë teknike të lëvizjeve trupore;
- flet në vija të përgjithshme për historinë e lindjes dhe zhvillimit të baletit kontemporan.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Kërcim /danci historik**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. **Rezultatet e të nxënit:**

Në përfundim të lëndës "Ushtrime të karakterit botëror", nxënësi:

- njihet me përmbajtjen e lëndës;
- njihet me stilet e kërcimeve të ndryshme të shekujve të mëparshëm;
- edukohet me ndjenjën e epokës dhe stilet përkatëse;
- performon duke ruajtur stilin dhe natyrën e çdo kërcimi;
- kupton ndikimin e kostumit në karakterin e lëvizjes përkatëse;
- realizon sjelljen e duhur në lidhje me partnerin e kërcimit dhe me kërcimtarët e tjerë.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Kërcim historik"**

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultate të pritshme**	**Orët**
Lëvizjet e kërcimeve	- Vendosja e trupit, kokës, duarve dhe këmbëve. - Pozicionet e këmbëve dhe të duarve. - Hapat në tempe të ndryshme muzikore. - Pas deegage. - Por de bras të ndryshme në kohën muzikore ¾ dhe 4/4. - Pas glisse në 2/4 dhe ¾. - Pas chasse në 2/4. - Pas eleve. - Galop. - Pas chasse dhe double chasse. - Pas balance. - Pas de basque. - Reveranc e shekullit XVI. - Hapat branelit. - Lëvizjet Bure. - Lëvizjet Pavana. - Lëvizjet Volta. - Reveranc e shekullit XVII. - Lëvizjet Alemanda. - Lëvizjet Minuet. - Lëvizjet Kuranta. - Lëvizjet Romanesk.	**Nxënësi:** - ekzekuton: • vendosjet e sakta të trupit dhe kokës kokës; • vendosjet e duarve sipas stilit të shekullit përkatës; • 5 pozicionet e këmbëve; • 3 pozicionet e duarve; - realizon në stilin dhe tempin përkatës: • hapa me thembër; • hapa në majë të gishtave; • hapa skenikë; - realizon saktë teknikisht dhe artistikisht lëvizjet e mësuara; - realizon teknikisht elementet kryesorëe të kërcimit historik; - ekzekuton saktë 4 format e pas chasse dhe format 1a, ab të double chasse; - realizon saktë lëvizjen: në vend, me zhvendosje përpara dhe mbrapa, me kthesë në 90° dhe 180°; - realizon etyde në 2/4, ¾ dhe 4/4 në stilin dhe mënyrat e kërkuara	22 orë

		nga mësuesi; - njeh dhe realizon lëvizjet e periudhave të ndryshme kohore; - realizon etydet dhe kërcimet e dhëna në koordinim të plotë të lëvizjeve të këmbëve, duarve dhe kokës; - ekzekuton: hap njësh, hap dysh, hap me reprise; - realizon në mënyrë të saktë: hapin kryesor të bures; vendosjen e duarve; rrotullimet; - realizon në mënyrë të saktë: pied en l'air (grue), pa pavana. hapin e thjeshtë dhe të përbërë; - realizon në mënyrë të saktë: • vendosjen në çift; • balaance; • tournee; • saute; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • hapat bazë përpara, anash dhe mbrapa; • pas grue pa hedhje; • mbajtjen e duarve në çift dhe vetëm; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • pas menuet; • pas menuat në të djathtë dhe në të majtë; • balance; • pas grave; balance – menuet; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • hapin kryesor; • pas grave; • pas de bourre; • coupe; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • chassee; • pas jete e vogël; • pas de bourree;	

		• pas ballotte; • atittude; - krijon marrëdhënie me partnerin dhe lëvizë në hapësirë në ritme të ndryshme muzikore.	
Kërcimet e shekullit XVI	- Branel. - Bure. - Pavana. - Volta	- ekzekuton: • kërcimin sipas koreografisë të dhënë nga mësuesi; • kërcimin duke respektuar stilin e branëlit dhe hapat përkatës; - ekzekuton: • kërcimin sipas koreografisë të dhënë nga mësuesi; • kërcimin duke respektuar stilin e kërcimit bure dhe hapat përkatës; - njeh lëvizjet kryesore dhe stilin e duhur; - njeh dhe realizon lëvizjet të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e teknikës së kërcimit klasik.	22 orë
Kërcimet e shekullit XVII	- Alemanda. - Minuet. - Kuranta. - Romanesk.	- njeh lëvizjet kryesore dhe stilin e duhur; - njeh dhe realizon lëvizjet të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e teknikës së këcimit klasik.	16 orë
Kërcimet nga repertori skenik	- Kërcimi me jastëk nga baleti "Romeo dhe Zhulieta". - Romaneska nga baleti " Rajmonda".	- ekzekuton saktë koreografinë e kërcimit; - respekon stilin dhe lëvizjet; - njeh aspektet historike të krijimit të kërcimeve; - realizon saktë nga ana teknike dhe artistike, duke respektuar stilin e epokës së kërcimeve.	14 orë

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit

Në klasën XI fillon njohja e nxënësit me kërcimet e shekujve të kaluar. Në fillim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mësimit të vendosjes së trupit, këmbëve, kokës dhe duarve sipas stilit të kërkuar në kërcimit historik, si dhe mësimit të elementeve bazë të kërcimit historik. Mbas mësimit më vete të çdo lëvizjeje, rekomandohet të lidhen 3- 4 nga lëvizjet e përvetësuara në etyde në kohë muzikore 2/4, ¾ dhe 4/4.

Përvetësimi i lëvizjeve bazë kërkon që më tej të vazhdohet me mësimin e lëvizjeve kryesre të kërcimeve që kanë dominuar në shekullin XVI dhe XVII. Mbas mësimit të lëvizjeve kryesore të kërcimeve duhet të mësohet vendosja në çift dhe marrëdhënia që krijojnë partnerët gjatë kërcimit, për ta konkluduar këtë punë në mësimin e kërcimeve me figurat e duhura.
Gjatë kësaj pune rekomandohet që përveç shpjegimit teorik të lëvizjeve të flitet dhe rreth kostumeve, historisë së krijimit së secilit kërcim, kushteve shoqërore të periudhës dhe njëkohësisht të shoqërohet me fragmente të literaturës.
Pas mësimit të kërcimeve të shekullit XVI dhe XVII rekomandohet të mësohen dhe disa pjesë nga repertori skenik për të parë përvetësimin e materialit të dhënë, por njëkohësisht për të parë dhe ndryshimet e lëvizjeve në materialet skenike.

Rekomandime për përcaktimin e repertorit koreografik		
- Etyde të ndryshme në lëvizjet e mësuara - Etyde me lëvizjet kryessore të kërcimeve të shekullit XVI - Kërcimet e Branelit, Bures, Pavanës dhe Oltës - Kërcimi me jastëk nga baleti “ Romeo dhe Zhulieta”	- Etyde për përsëritjen e elementeve bazë - Etyde me lëvizjet e kërcimeve të shekullit XVII - Kërcimet Alemana, Minuet, Kuranta dhe Romaneska - Romaneska nga Baleti “Rajmonda”	- Kërcimet e shekullit XVI dhe XVII. - Repertori skenik: - Kërëcimi me jastëk nga baleti “Romeo dhe Zhulieta” - Romaneska nga baleti “ Rajmonda”

Rekomandime për vlerësimin e nxënësve

Niveli maksimal: Nxënësi merr vlerësimin maksimal kur ka përvetësuar të gjitha lëvizjet e dhëna nga mësuesi dhe arrin të luajë teknikisht dhe me stilin e duhur (artistikisht) etydet e ndërtuara, kërcimet e dhëna dhe materialet nga repertori skenik.

Niveli mesatar: Nxënësi merr vlerësim mesatar kur ka përvetësuar materialin e dhënë, por nuk arrin të realizojë lëvizjet, etydet, kërcimet në teknikën e duhur ose në stilin e uhur. Nxënësi mund të vlerësohet mesatar edhe kur arrin të realizojë teknikisht dhe artistikisht lëvizjet, por nuk arrin të krijojë marrëdhënien e duhur me partnerin dhe me kërcimtarët e tjerë.

Niveli dobët: Nxënësi merr vlerësim të dobët, kur nuk përvetëson tërësisht programin e dhënë dhe kur lëvizjet e përvetësuara nuk kanë realizim teknik ose artistik.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Kërcim historik**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e të nxënit:

Në përfundim të lëndës "**Kërcim historik**", nxënësi:
- njihet me përmbajtjen e lëndës;
- njihet me stilet e kërcimeve të ndryshme të shekujve të mëparshëm;
- edukohet me ndjenjën e epokës dhe me stilet përkatëse;
- realizon stilin dhe natyrën e çdo kërcimi;
- kupton ndikimin e kostumit në karakterin e lëvizjes përkatëse;
- mëson sjelljen e duhur në lidhje me partnerin e kërcimit dhe me kërcimtarët e tjerë.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kërcim historik"

Programi i detyrueshëm	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Lëvizjet e kërcimeve	- *Reveranc* e shekullit XVIII. - Lëvizjet e *Gavo*te. - Lëvizjet *Zhiga*. - Lëvizjet *Minuet* i shpejtë**.** - *Reveranc* e shekullit XIX. - Lëvizjet polonez. - Lëvizjet mazurka. - Lëvizjet Vals. - Lëvizjet Polka. - Lëvizjet e Kadrilit francez. - Chassee. - Pas eleves. - Vendosja në çift. - Chaine anglaise. - Chaine des dames. - Promenade. - Demi chaine. - Travese.	**Nxënësi:** - ekzekuton: • përshëndetjet; • hapat e lehtë me ndalim në poza të ndryshme; • pas de zephir; • pas de bourree me zhvendosje përpara; • pozicionet e ndryshme të duarvee solo dhe në çift; • pas assamble; • entrechat quatre; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • sissone tombee; • pas de bourree; • pas jete e vogël; • assemble me kthesë; • sissone ouverte; • temps leve; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • pas menuet; • pas menuat në të djathtë dhe në të majtë; • balance; • pas grave; • balance – menuet; • glisse; • arabesk; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike:	18 orë

		• pas polones; • pas polones në rreth çift; • pas polones dos a dos; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • pas couru; • pas gala; • pas boiteux; • pas coupe; • coupe de talon; • çelësi; • rrotullimet dos a dos; - ekzekuton nga ana teknike dhe artistike: • valse a trois temps; • valse a trois tempsa solo në linjë dhe në rreth. me rrotullim nga e djathta; • valse a trois tempsa çift në linjë dhe në rreth me rrotullim nga e djathta; • valse a trois tempsa solo në linjë dhe në rreth, me rrotullim nga e majta; • valse a trois tempsa çift në linjë dhe në rreth me rrotullim nga e majta; • valse a deux temps; • “ Rruga e valsit” - ekzekuton saktë: • pas polka përpara, anash dhe mbrapa në vend dhe me kthim 90° dhe 180°; • pas polka me zhvendosje përpara dhe mbrapa; • pas polka anash me rrotullim solo dhe në çift; - ekzekuton saktë: • chassee; • pas eleves; • vendosja në çift; • chaine anglaise; • chaine des dames; • promenade; • demi chaine; • travese; - realizon teknikisht dhe artistikisht lëvizjet e mësuara më parë të kombinuara me 2-3 nga lëvizjet e reja; - realizon etyde me lëvizjet e përvetësuara. - kupton ndryshimet e lëvizjeve në kërcimet e ndryshme .	
Kërcimet e shekullit XVIII	- Gavot. - Zhiga. - Minuet i shpejtë.	- ekzekuton kërcimin sipas koreografisë të dhënë nga mësuesi; - njeh lëvizjet kryesore dhe stilin e duhur, për secilin nga kërcimet; - kupton zhvillimin e kërcimit nga shekulli	12 orë

		në shekull; - njeh dhe mëson kostumet dhe komunikimin në periudha të ndryshme kohore.	
Kërcimet e shekullit XIX	- Polonez. - Mazurka. - Vals. - Polka. - Kadrili francez (6 figurat).	- njeh lëvizjet kryesore dhe stilin e duhur, për secilin nga kërcimet; - kupton zhvillimin e kërcimit nga shekulli në shekull; - njeh dhe mëson kostumet dhe komunikimin në periudha të ndryshme kohore; - ekzekuton kërcimin sipas koreografisë së dhënë nga mësuesi.	20 orë
Kërcimet nga repertori skenik	- Minueti klasik nga opera " Don Zhuani". - Sarabanda nga baleti "Flakët e Parisit". - Polonez nga baleti "Bukuroshja e fjetur " ose nga opera " Eugen Onegin ".	- ekzekuton saktë koreografinë e kërcimit; - respekon stilin dhe lëvizjet; - njeh aspektet historike të krijimit të kërcimeve; - realizon saktë nga ana teknike dhe artistike duke respektuar stilin e epokës së kërcimeve.	18 orë

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit

Klasa XII është klasa e fundit të përgatitjes për artistin e ri të baletit. Gjatë kësaj klase mësohen kërcimet e shekullit XVIII edhe shekullit XIX që patën një ndryshim të rëndësishëm për kohën kur kanë lindur. Teknika e këtyre kërcimeve përafrohet me atë të kërcimit klasik, gjë që kërkon një përvetësim shumë të mirë të lëvizjeve të veçanta të këtyre kërcimeve. Një rol të rëndësishëm në këtë klasë duhet t'u jepet etydeve të ndryshme të ndërtuara në lëvizjet kryesore të kërcimeve për të arritur një realizim teknikisht dhe artistikisht më të mirë të kërcimeve.

Rekomandime për përcaktimin e repertorit koreografik		
- Etyde me lëvizjet e mësuara - Kërcimet e Gavotës, Zhigës dhe Minuetit - Minueti klasik nga opera " Don Zhovani"	- Etyde të shkurtra me lëvizjet kryesore të kërcimeve të shekullit XIX - Kërcimet e polonezit, mazurkës, polkës, valsit dhe kadrilit francez - Sarabanda na baleti "Flakët e Parisit" - Polonez nga baleti " Bukuroshja e fjetur"	- Kërcimet e shekullit XVIII dhe XIX - Minuet klasik nga opera e " Don Zhovanit" - Sarabanda nga baleti " Flakët e Parisit " - Polonez nga baleti " Bukuroshja e Fjetur"

Në klasën XI fillon njohja e nxënësit me kërcimet e shekujve të kaluar. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mësimit, vendosjes së trupit, këmbëve, kokës dhe duarve, sipas stilit të kërkuar të

kërcimit historik dhe mësimit të elementeve bazë të kërcimit historik. Mbas mësimit më vete të çdo lëvizjeje, rekomandohet të lidhen 3-4 nga lëvizjet e përvetësuara në etyde, në kohë muzikore 2/4, 3/4 dhe 4/4.

Përvetësimi i lëvizjeve bazë kërkon që më tej të vazhdohet me mësimin e lëvizjeve kryesore të kërcimeve që kanë dominuar në shekujve XVI dhe XVII. Mbas mësimit të lëvizjeve kryesore të kërcimeve, duhet të mësohet vendosja në çift dhe marrëdhënia që krijojnë partnerët gjatë kërcimit të çdo kërcimi, për ta konkluduar këtë punë në mësimin e kërcimeve me figurat e duhura.

Gjatë kësaj pune, rekomandohet që, përveç shpjegimit teorik të lëvizjeve, të flitet dhe rreth kostumeve, historisë së krijimit të secilit kërcim, kushteve shoqërore të periudhës dhe njëkohësisht, brenda mundësive, shpjegimi të shoqërohet me fragmente të literaturës.

Mbas mësimit të kërcimeve të shekujve XVI dhe XVII, rekomandohet të mësohen dhe disa pjesë nga repertori skenik, për të parë përvetësimin e materialit të dhënë, por njëkohësisht për të parë dhe ndryshimet e lëvizjeve në materialet skenike.

Klasa XII është klasa e fundit e përgatitjes për artistin e ri të baletit. Në këtë klasë mësohen kërcimet e shekullit XVIII edhe ato të shekullit XIX, të cilat patën një ndryshim të rëndësishëm për kohën kur kanë lindur. Teknika e këtyre kërcimeve përafrohet me atë të kërcimit klasik, gjë që kërkon një përvetësim shumë të mirë të lëvizjeve të veçanta të këtyre kërcimeve. Një rol të rëndësishëm në këtë klasë duhet t'u jepet etydeve të ndryshme të ndërtuara në lëvizjet kryesore të kërcimeve për të arritur më tej një realizim teknikisht dhe artistikisht më të mirë të kërcimeve. Gjatë kësaj pune, rekomandohet që, përveç shpjegimit teorik të lëvizjeve, të flitet dhe rreth kostumeve, historisë të krijimit së secilit kërcim, kushteve shoqërore të periudhës dhe njëkohësisht, brenda mundësive, shpjegimi të shoqërohet me fragmente të literaturës.

4. VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur nuk arrin të realizojë:

- lëvizjet, etydet, kërcimet në teknikën e duhur ose në stilin e duhur;
- teknikisht dhe artistikisht lëvizjet,;
- dhe të krijojë marrëdhënien e duhur me partnerin dhe me kërcimtarët e tjerë.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur interpreton mirë:

- ka përvetësuar materialin e dhënë, por nuk arrin të realizojë lëvizjet, etydet, kërcimet në teknikën e duhur ose në stilin e duhur;
- arrin të realizojë teknikisht dhe artistikisht lëvizjet, por nuk arrin të krijojë, marrëdhënien e duhur me partnerin dhe me kërcimtarët e tjerë.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- interpreton shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Valle popullore**
Klasa: **X**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Valle popullore", nxënësi:

- njeh rëndësinë që ka kjo lëndë në formimin e kulturës artistike profesionale të një kërcimtari;
- kupton mirë morfologjinë e kërcimit popullor dhe përmbajtjen e pasur të traditës së popullit tonë;
- realizon artistikisht shprehitë e valles sonë popullore dhe asaj të kultivuar;
- njeh teorikisht prejardhjen burimore të motivit, përpunimit të lëvizjes dhe karakterin plastiko-emocional;
- fiton aftësitë kërcyese për të forcuar teknikisht vallen sipas ndarjes krahinore;
- ekzekuton motivin e valleve, ndarë në grupe vajzë-djalë dhe, më pas, ekzekuton perfekt në çift për t'u përvetësuar sa më mirë lëvizja.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Valle popullore"

Programi i detyrueshëm	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Valle kosovare	- Prezantimi i karakterit të valles kosovare. - Ndërtimi i pjesës së vajzave. - Ndërtimi i pjesës së djemve. - Ndërtimi i pjesës së parë. - Bashkimi i vajzave me djemtë. - Ndërtimi i valles. - Lidhja e gjithë valles kosovare.	**Nxënësi:** - përvetëson motivet e valles kosovare**;** - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles; - arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	14 orë
Valle e rëndë tiranase	- Prezantimi i valles së rëndë tiranase. - Ndërtimi i pjesës së parë. Ndërtimi i pjesës së vajzave.	- përvetëson motivet e valles tiranase; - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së	20 orë

	Ndërtimi i pjesës së djemve. Lidhja e valles, vajza dhe djem. - Ndërtimi i zhvillimit të valles, pjesa e dytë. - Figurat në rreth të valles. Momentet e valles së rëndë tiranase. - Ndërtimi i finales. Lidhja e valles së Tiranës.	valles; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles; - arrin tenikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	
Valle e Valbonës	- Prezantimi i valles së Valbonës. - Ndërtimi i pjesës së parë të valles. - Ndërtimi i pjesës së vajzave. Ndërtimi i pjesës së djemve. Figurat në rreth të djemve dhe vajzave. - Bashkimi vajza dhe djem. Ndërtimi i pjesës së dytë. Lidhja e gjithë valles.	- përvetëson motivet e valles së Valbonës; - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles;) arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	18 orë
Valle e Librazhdit	- Prezantimi i valles së Librazhdit. - Ndërtimi i pjesës së parë të valles. - Ndërtimi i pjesës së vajzave. Ndërtimi i pjesës së djemve. Lidhja e valles, vajza dhe djem. - Ndërtimi i zhvillimit të valles, pjesa e dytë. - Ndërtimi i finales. Lidhja e valles së Librazhdit. Përsëritje e valles së Librazhdit dhe e valles së Valbonës.	- përvetëson motivet e valles së Librazhdit; - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles;) arrin teknikisht dhe artistikisht	18 orë

		bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Valle popullore**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Valle popullore", nxënësi:

- njeh mirë morfologjinë e kërcimit popullor dhe përmbajtjen e pasur të traditës së popullit tonë;
- realizon artistikisht shprehitë e valles sonë popullore dhe asaj të kultivuar;
- njeh teorikisht prejardhjen burimore të motivit, përpunimit të lëvizjes dhe karakterin plastiko-emocional;
- fiton shprehitë kërcyese dhe forcohet teknikisht ,vallja sipas ndarjes krahinore;
- realizon vendosjen dhe impostimin e lëvizjeve me temporitme të moderuara dhe ruan ndjenjën karakteristike të pozës;
- bën ekzekutimin e motivit, i ndarë në grupe vajzë-djalë, dhe, më pas, ekzekutimin perfekt në çift për t'u përvetësuar sa më mirë lëvizja;
- fiton shprehjen e veçorive thelbësore të strukturës plastikore e muzikore të lëvizjes.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Valle popullore"

Programi i detyrueshëm	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Vallja e Tropojës	- Prezantimi i karakterit të valles së Tropojës. Ndërtimi i pjesës së parë të vajzave. - Ndërtimi i pjesës solistike. Përsëritje e pjesës së parë. Ndërtimi i pjesës së dytë të valles. - Bashkimi i valles. Lidhja e gjithë valles së Tropojës.	**Nxënësi:** - përvetëson motivet e valles së Tropojës; - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles;) arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	14 orë
Vallja Gorarçe	- Prezantimi i valles *Gorarçe.* - Ndërtimi i pjesës së parë. Ndërtimi i pjesës së parë të djemve.	- përvetëson motivet e valles Gorarçe*;* - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së	20 orë

	- Ndërtimi i pjesës së dytë të djemve. - Lidhja e valles e dy pjesëve të para. Ndërtimi i zhvillimit të valles. - Figurat në rreth të valles. - Momentet e pjesës solistike. - Ndërtimi i finales. Lidhja e valles Gorarçe.	valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles; - arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	
Vallja e Shupalit	- Prezantimi i valles së *Shupalit*. - Ndërtimi i pjesës së parë të valles. - Ndërtimi i pjesës së vajzave. - Ndërtimi i pjesës së djemve. - Figurat në rreth, të djemve dhe vajzave. - Bashkimi vajza dhe djem. Ndërtimi i pjesës së dytë. Lidhja e gjithë valles.	- përvetëson motivet e valles së Shupalit - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles;) arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	14 orë
Vallja e shqipeve	- Prezantimi i valles së *shqipeve*. - Ndërtimi i pjesës së parë. - Ndërtimi i pjesës së vajzave. - Ndërtimi i pjesës së djemve. - Lidhja e valles vajza dhe djem. - Ndërtimi i zhvillimit të valles, pjesa e dytë. - Figurat në rreth të valles. - Momentet e valles së shqipeve. - Ndërtimi i finales.	- përvetëson motivet e valles së shqipeve; - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles;) arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe	19 orë

		me lëvizjet e duarve.	

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Valle popullore**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Valle popullore", nxënësi:

- njeh mirë morfologjinë e kërcimit popullor dhe përmbajtjen e pasur të traditës së popullit tonë;
- realizon artistikisht shprehitë e valles sonë popullore dhe asaj të kultivuar;
- njeh teorikisht prejardhjen burimore të motivit, përpunimit të lëvizjes dhe karakterin plastiko-emocional;
- fiton shprehitë kërcyese dhe forcohet teknikisht vallja, sipas ndarjes krahinore.
- realizon vendosjen dhe impostimin e lëvizjeve me temporitme të moderuara dhe ruan ndjenjën karakteristike të pozës;
- bën ekzekutimin e motivit, i ndarë në grupe vajzë-djalë, dhe, më pas, ekzekutimin perfekt në çift për t'u përvetësuar sa më mirë lëvizja;
- të fitojë shprehjen e veçorive thelbësore të strukturës plastikore e muzikore të lëvizjes.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Valle popullore"

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**
Vallja "Festa e madhe"	- Prezantimi i karakterit të valles "*Festa e madhe*". - Ndërtimi i pjesës së vajzave. - Ndërtimi i pjesës së djemve. - Ndërtimi i pjesës së parë. - Bashkimi i vajzave me djemtë. - Ndërtimi i valles. - Lidhja e gjithë valles "Festa e madhe".	**Nxënësi:** - përvetëson motivet e valles "Festa e madhe"**;** - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles; - arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	24 orë
Vallja "Në garë"	- Prezantimi i valles "*Në garë*". - Ndërtimi i pjesës së parë të valles. - Ndërtimi i pjesës së vajzave. - Ndërtimi i pjesës së	- përvetëson motivet e valles "Në garë"**;** - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj;	28 orë

	djemve. - Figurat në rreth të djemve dhe vajzave. - Bashkimi vajza dhe djem. - Ndërtimi i pjesës së dytë. - Lidhja e gjithë valles.	- arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles; - arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	
Vallja "Barinjtë e Korabit"	- Prezantimi i valles "*Barinjtë e Korabit*". - Ndërtimi i pjesës së parë të valles. - Ndërtimi i pjesës së djemve. - Lidhja e valles. - Ndërtimi i zhvillimit të valles, pjesa e dytë. - Ndërtimi i finales. - Lidhja e valles "*Barinjtë e Korabit*". - Përsëritje e valles "*Barinjtë e Korabit* ".	- përvetëson motivet e valles "Barinjtë e Korabit"**;** - ekzekuton motivet e valles; - perfeksionon lëvizjet e finales së valles; - interpreton vallen në karakterin e saj; - arrin artistikisht teknikën e valles; - kryen sinkronizimin e lëvizjes me muzikën dhe harmonizimin në çift; - përvetëson botën shpirtërore nëpërmjet interpretimit të valles; - arrin teknikisht dhe artistikisht bashkërendimin e plotë të lëvizjeve me nuancat e trupit dhe me lëvizjet e duarve.	16 orë

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Lënda "Valle popullore" është një nga lëndët më të rëndësishme për edukimin e nxënësve me shprehitë e valles sonë popullore dhe asaj të kultivuar skenike. Përvetësimi i shprehive plastike të valles sonë popullore është baza nga ku nxënësi do të interpretojë artin koreografik të kultivuar me frymë të theksuar kombëtare.

Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit jo vetëm që mësojnë morfologjinë e kërcimit popullor, por dhe përmbajtjen e pasur të traditës së popullit tonë që nëpërmjet valles ka ditur të shprehë botën e tij shpirtërore. Repertori i valles popullore përfshin valle tradicionale burimore dhe valle të përpunuara të Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe të Valleve Popullore, duke pasur parasysh vallet me leksik të kristalizuar, si shembuj më të mirë të lëvizjes koreografike.

Nxënësit:

- duhet të arrijnë të kërcejnë repertorin e valleve të grupeve profesioniste;
- duhet të arrijnë të kërcejnë vallen virtuoze folklorike burimore;
- duhet të përvetësojnë interpretimin e valles popullore të kultivuar dhe burimore, duke marrë për bazë arritjet më të mira të kohës.

4. Vlerësimi

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur nuk arrin:

- të realizojë lëvizjet, etydet, kërcimet në teknikën e duhur ose në stilin e duhur;
- të realizojë teknikisht dhe artistikisht lëvizjet dhe të krijojë marrëdhënien e duhur me partnerin dhe me kërcimtarët e tjerë.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:
- interpreton *mirë;*
- ka përvetësuar materialin e dhënë, por nuk arrin të realizojë lëvizjet, etydet, kërcimet në teknikën e duhur ose në stilin e duhur;
- arrin të realizojë teknikisht dhe artistikisht lëvizjet, por nuk arrin të krijojë marrëdhënien e duhur me partnerin dhe me kërcimtarët e tjerë.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:
- interpreton *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Mjeshtëri aktori**
Klasa: **XII**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të lëndës "Mjeshtëri aktori",nxënësi:

- njihet me rëndësinë që ka kjo lëndë në formimin e kulturës artistike profesionale të një kërcimtari;
- thellohet më shumë në njohjen e cilësive specifike aktoriale;
- kultivon elementet e figurës artistike ndërthurur më lëvizjen
- demonstron botën e brendshme psikologjike dhe plastikën fizike të personazhit;
- demonstron elementet specialë që ushtron si të detyrueshme realizimin e karakterit.

2. Përmbajtja tematike të lëndës *"Mjeshtëri aktori"*

Programi i detyrueshëm	**Temat mësimore**	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**
Vëmendja skenike	- Kuptimi dhe rëndësia e mjeshtërisë së aktorit. - Rëndësia e mizanskenës në një balet. - Vëmendja skenike nga balete të ndryshme. - Aftësia vezhguese.	**Nxënësi:** - njeh perceptimet dhe ndijimet; - emërton llojet e gjendjeve emocionale; - shpjegon vëmendjen dhe aftësinë vëzhguese.	7 orë
Rrethanat dhe veprimi	- Rrethanat skenike nga balete të ndryshme. - Marrëdhënia me ngjarjen, faktin dhe vendin e veprimit. - Veprimi skenik. - Realizimi i veprimit në rrethanat e dhëna me levizje të ndryshme. - Imagjinata skenike.	- njeh rrethanat skenike; - shpjegon marëdhënien me ngjarjen; - realizon veprimet me rrethanat.	12 orë
Monologu i brendshëm Pantomima **Marrëdhënia me partnerin**	- Analizë e personazheve nga baleti "Lola". - Analizë e personazheve nga baleti "Arrëthyesi". - Pantomima. - Monologu i brendshëm. - Figura artistike. - Biografia e personazhit. - Puna me rolin. - Etyd me partner.	- njeh dhe analizon personazhe nga balete te ndryshme; - realizon dhe interpreton etyd me partner. - shpjegon figurën dhe biografinë e personazhit.	15 orë

Dega: **Koreografi**
Specialiteti: **Kërcimtar**
Lënda: **Repertor skenik**
Klasa: **XI**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Repertor skenik", nxënësi:

- thellohet në zbërthimin dhe realizimin e drejtpërdrejtë të koreografisë origjinale;
- thellohet në njohjen analitike të repertorit skenik koreografik;
- thellohet në njohjen praktike –teorike dhe vizuale të një koreografie të caktuar.
- formohet përmes njohjes së drejtpërdrejtë të repertorit skenik koreografik;
- përvetëson vështirësitë teknike të një vepre koreografike;
- kupton gjendjet e ndryshme emocionale në format e baletit klasik;
- kupton rëndësinë e shoqërimit muzikor për të interpretuar me saktësi dhe muzikalitet.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Repertori skenik"

Programi i detyrueshëm	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme	Orët
Pas de trios nga baleti "Paquita"	- *Minkus-Paquita-Deldevez-Petipa 1846/ 47-Mazilier (version Petipa 1847;1881) nga akti i parë.* - Pas de troi. - Variacioni i parë (vajzës). - Variacioni i dytë (djalë). - Variacioni i tretë (vajzë). - Koda. - Lidhja e Pas de trois.	***Nxënësi:*** - njihet me përmbajtjen e veprës; - realizon teknikisht dhe artistikisht variacionet; - njeh karakterin e kërcimit dhe të dijë të interpretoj në grup; - realizon teknikisht kërcimin dhe është sinkron gjatë tij.	26 orë
